# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6904
E enjte, 25 maj 2023
Çmimi 0.40 €


## Vendet në tranzicion: Shqipëria dhe Kosova, përmirësim të lehtë, por problemet thelbësore vazhdojnë

FAQE3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE" I AKREDITUARI I GJYKATËS SPECIALE, SKËNDER MUSA

# GJYKATA SPECIALE ËSHTË DUKE E TEPRUAR ME SEANCA TË MBYLLURA

FAQE 4



**- Nuk ka logjikë që të gjithë dëshmitarët të dëgjohen në seanca të mbyllura**

**- Edi Rama është duke bërë një punë të shkëlqyeshme në favor të vërtetimit të pafajësisë së krerëve të UÇK-së**

Avokati i akredituar i Gjykatës Speciale, Skënder Musa, ka vlerësuar se Gjykata Speciale është duke e tepruar me mbajtjen e seancave të mbyllura në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së. Musa në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se nëse vazhdohet me seanca të tilla, Specialja rrezikon ta shkelë parimin e publicitetit. Ndërsa sa i përket kohëzgjatjes së këtij procesi gjyqësor, avokati Musa ka thënë se nuk do të zgjasë aq sa ka planifikuar ZPS-ja. Duke iu referuar provave të ZPS-së, Musa ka vlerësuar se në fund të këtij procesi liderët e UÇK-së do të shpallen të pafajshëm. Krahas kësaj, ai e ka kritikuar heshtjen e institucioneve të Kosovës karshi Speciales dhe ka lavdëruar angazhimin e shtetit shqiptar dhe kryeministrin Edi Rama për mbrojtje të UÇK-së

## OPINION

### RËNIA E BAKHMUTIT, DËSHTIMI MË I MADH I UDHËHEQËSVE KOSOVARË NË SKENËN NDËRKOMBËTARE!

F. 7

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



### PREDIKIMET SHKENCORE TË NAIM KRASNIQIT PO KONFIRMOHEN

F. 7

Shkruan: Dr. Hajdin ABAZI



## AKTUALE



### SI MUND T'I LUFTOJË OBSH-JA PANDEMITË NË TË ARDHMEN?

F. 2

## EKONOMI



### KURTI: PO NDËRTOJMË PROJEKTIN E PARË NË BALLKAN PËR NGROHJE QENDRORE ME ENERGJI DIELLORE

F. 8

## SPORT

### TREPÇA SYNON BARAZIMIN, BESA TITULLIN

F. 14

### KOSOVA SHPALL TË MBYLLUR EMERGJENCËN ME COVID-19

FAQE 5




### KDI-ja PUBLIKON INDEKSIN VJETOR TË TRANSPARENCËS NË QEVERISJEN KOMUNALE, SKENDERAJ I PARI




RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Si mund t'i luftojë OBSh-ja pandemitë në të ardhmen?



**Gjenevë, 24 maj** - Janë duke u kryer negociata dhe krijuar plane nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) se si të përballet me pandemitë, nëse ndodh që të ketë ndonjëherë në të ardhmen.
Më 24 maj 2024 pritet që të realizohet një marrëveshje ligjërisht e detyrueshme e që duhet të miratohet nga 194 vendet anëtare të organizatës.
Për shefin e OBSh-së, Tedros Adhanom Ghebreyesus, një pakt i ri është prioritet tani, duke shtuar se "të gjithë duhet të kemi angazhim brezash në mënyrë që mos t'i kthehemi ciklit të vjetër të panikut dhe neglizhencës", në asamblenë vjetore të agjencisë së OKB-së.
Ky pakt i kërkuar ka për qëllim të mbështetë dhe ngjallë organizatat dhe trupat mbrojtës në gjithë botën në luftën kundër patogjeneve të mundshëm pas pandemisë së Covid-19, e cila vrau afër 7 milionë njerëz në gjithë botën.

## Çfarë është traktati pandemik?

OBSh-ja tashmë ka rregulla të detyrueshme të njohura si Rregulloret Ndërkombëtare të Shëndetit me të cilat që nga viti 2005 përcaktohen detyrimet për ato vende ku ngjarje që kanë të bëjnë me shëndetin publik kanë potencial për t'i kaluar kufijtë. Këto përfshijnë këshillimin e menjëhershëm të OBSh-së për një emergjencë shëndetësore dhe masat për tregtinë dhe udhëtimin.
Këto rregullore, të cilat u miratuan gjatë përhapjes së virusit SARS në vitet 2002-2003, aktualisht shihen si të përshtatshme në rast të përhapjes së sëmundjeve si Ebola, por të pamjaftueshme për një pandemi në nivel global.
Pas përhapjes së Covid-19, këto rregullore janë duke u shqyrtuar. Vendet anëtare kanë vendosur që traktati i ri më gjithëpërfshirës i pandemisë duhet të jetë ligjërisht i zbatueshëm për ata që regjistrohen duke kapërcyer dyshimet e hershme nga Kombet e Bashkuara.
Pas Konventës Kuadër të vitit 2003 për Kontrollin e Duhanit, një traktat që përpiqet ta dekurajojë pirjen e duhanit nëpërmjet taksave dhe rregulloreve për etiketimin dhe reklamimin, ky traktat i pandemive do të ishte pakti i dytë shëndetësor i këtij lloji.
Megjithatë, ky traktat ka tërhequr kritika në rrjetet sociale, kryesisht nga kundërshtarët e krahut të djathtë, të cilët shqetësohen se mund të rezultojë në transferimin e pushtetit nga shtetet tek OBSh-ja.
Organizata e kundërshton këtë, duke theksuar se qeveritë janë në krye të diskutimeve dhe kanë të drejtë ta refuzojnë marrëveshjen.

## Si e shohin shtetet këtë traktat?

Përkrahësi kryesor i marrëveshjes shihet të jetë Bashkimi Evropian, i cili e propozoi vetë këtë traktat. Pas akuzave për "aparteidin e vaksinave" nga shefi i përgjithshëm i OBSh-së, Tedros, vendet në zhvillim, veçanërisht ato në Afrikë, janë të interesuar për t'i shfrytëzuar diskutimet që të përmirësohet qasja në vaksina.
Drafti më i fundit prej 208 faqesh, i cili u arrit pas pesë raundesh diskutimesh zyrtare, ka ende shumë paqartësi, sidomos terminologji të paqartë, si përkufizimi i fjalës "pandemi". Me kaq shumë vende anëtare të përfshira, nënshkrimi i marrëveshjes mund të jetë më i ndërlikuar.

## Si do të funksiononte?

Nuk është ende e qartë se si rregulloret e vitit 2005 dhe marrëveshja e re e pandemisë mund të përshtaten së bashku, mirëpo sugjerohet se ato duhet të jenë plotësuese në mënyrë që rregullat ekzistuese të zbatohen për përhapje lokale me rregullat e reja që fillojnë nëse OBSh-ja shpall një pandemi - diçka që aktualisht nuk ka mandat për ta bërë. Gjithashtu, nuk është ende e qartë se çfarë ndodh nëse nuk respektohen masat. Një bashkëdrejtues i bisedimeve tha se do të pëlqente të kishte një proces rishikimi me kolegët nga shtetet në vend se të sanksionoheshin shtetet që nuk pajtohen.

## Çfarë reformash të tjera janë në proces?

Gjithsej 300 amendamente janë propozuar nga kombet në diskutime të veçanta mbi reformimin e udhëzimeve të vitit 2005. Sugjerimet fillestare nga Uashingtoni kërkuan transparencë dhe t'i sigurojnë OBSh-së qasje më të shpejtë në zonat epidemike. Sidoqoftë, OBSh-ja pretendon se Pekini ende po fsheh të dhëna klinike nga rastet e hershme që mund të përfshijnë tregues për origjinën e virusit SARS-CoV-2. Kina lejoi ekipet e ekspertëve të udhëhequr nga OBSh-ja që ta vizitojnë epiqendrën e Covid-19 në Vuhan. (Përgatiti: Albina Kastrati / Rel)

# Caktohet data për gjyqin kundër ish-presidentit Trump

**Uashington, 24 maj** - Një gjykatë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës caktoi 25 marsin e vitit 2024 si datë për gjykimin ndaj ish-presidentit Donald Trump. Kjo periudhë përkon me kulmin e fushatës zgjedhore për kandidatin presidencial brenda Partisë Republikane.
Gjykatësi i Manhatanit të Nju-Jorkut, Juan Merchan, njoftoi për këtë datë gjatë një seance ku Trumpi mori pjesë përmes një video-lidhjeje.
Muajin e kaluar ish-presidenti amerikan u deklarua se ishte i pafajshëm për 34 akuza për falsifikim të të dhënave të biznesit, në lidhje me pagesat që kompania e tij i kishte dhënë ish-avokatit të tij Michael Cohen.
Trumpit iu dha leje që mos të paraqitej personalisht në gjykatë me qëllim të shmangies së sfidave të mëdha të sigurisë dhe logjistikës që pasuan pas shpalljes së akuzës kundër tij muajin e kaluar.
Prokurorët thonë se këto pagesa kishin për qëllim rimbursimin dhe kompensimin e avokatit Cohen për kryerjen e pagesave në këmbim të heshtjes gjatë fushatës së vitit 2016 lidhur me akuza për marrëdhënie jashtëmartesore.
Trump mohon të ketë pasur lidhje jashtëmartesore dhe thotë se ndjekja penale është e motivuar politikisht.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Vendet në tranzicion: Shqipëria dhe Kosova, përmirësim të lehtë, por problemet thelbësore vazhdojnë

**Prishtinë, 24 maj** - Organizata Freedom House thotë se ndikimi i luftës në Ukrainë, si pasojë e agresionit rus, u ndje gjatë vitit të kaluar në 29 vendet nga Evropa Qendrore në Azinë Qendrore që analizohen në raportin e saj "Vendet në tranzicion". Në raportin e këtij viti titulluar "Lufta thellon ndasitë rajonale", që analizon zhvillimet e vitit 2022 dhe që u bë publik të mërkurën, thuhet se në vend që t'i forconin lidhjet në rajon, "kërcënimet e sigurisë, kriza historike e refugjatëve dhe probleme ekonomike të lidhura me konfliktin, kanë thelluar hendekun mes autokracive dhe demokracive dhe kanë shkaktuar ndryshime përçarëse në politikat e jashtme të qeverive të veçanta". "Megjithëse disa vende bënë zgjedhje të qarta në favor të një të ardhmeje më demokratike gjatë vitit 2022, rezultati i përgjithshëm ishte një vit i 19-të me radhë të rënies së demokracisë në rajon", thuhet në raport.

## Gjendja e demokracisë në Shqipëri

Edhe në vitin 2022 Shqipëria ishte në kategorinë e regjimeve hibride/demokraci në tranzicion. Vlerësimi i përgjithshëm për Shqipërinë shënoi një përparim të lehtë në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 falë një rritjeje të vlerësimit në luftën kundër korrupsionit. "Vlerësimi për luftën kundër korrupsionit u rrit nga 2.75 në 3.00 pikë falë një sërë aktakuzash dhe dënimesh të profilit të lartë të ish-zyrtarëve nga Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), si dhe rolit të saj proaktiv në nxitjen e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar", thuhet në raport. Kjo bëri që vlerësimi i përgjithshëm të rritet nga 3.75 në 3.79, në një shkallë vlerësimi nga 1 deri në 7 pikë, ku 1 është niveli më i ulët i demokracisë e 7 më i larti.
Megjithatë, treguesit e tjerë të demokracisë mbeten të pandryshuar dhe raporti thotë se institucionet demokratike të Shqipërisë sfidohen nga politika partiake klienteliste, zvarritja e procesit të vetingut në drejtësi dhe korrupsioni i shfrenuar. "Korrupsioni mbetet i përhapur, duke kontribuar në mosfunksionimin e institucionit publik dhe duke kufizuar aftësinë e tij për të ofruar shërbime efektive. Megjithëse agjencitë e reja ligjzbatuese si SPAK, krijuar në vitin 2019, tregojnë shenja premtuese në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në nivelet më të larta, ndikimi politik mbi gjyqësorin në rastet e korrupsionit vazhdon ende të jetë shqetësim", thuhet në kapitullin për Shqipërinë të raportit "Vendet në tranzicion 2023", që e ka siguruar "Zëri i Amerikës". "Drejtësia bazë për shumë qytetarë shqiptarë vërtet mungon. Dhe është gjithashtu një mjedis, ashtu si pjesa më e madhe e rajonit, ku mediet e pavarura po tkurren, aktorët e shoqërisë civile janë në pozitë të vështirë, duke shtuar gjithnjë e më shumë pengesat dhe kërcënimet", i thotë "Zërit të Amerikës", Alexandra Karppi, një nga autoret e raportit. Me gjithë përmirësimin modest në treguesin e korrupsionit, raporti thotë se pati pak mundësi për reforma të mëtejshme para zgjedhjeve lokale të 14 majit këtë vit.

## Kosova dhe procesi i negociatave

Kosova shënoi një përmirësim të lehtë nga 3.25 vitin e kaluar në 3.29 këtë vit. "Marrëdhëniet e tensionuara prej kohësh mes Serbisë dhe Kosovës vazhduan ta minojnë përparimin demokratik në të dyja vendet, edhe pse në aspekte të ndryshme. Përpjekje të jashtëzakonshme nga shoqëria civile e Kosovës për të realizuar ndryshime pozitive të politikave mbi dhunën me bazë gjinore dhe ndarjet etnike u lanë nën hije gjatë vitit nga një rritje e dhunës në Veriun me shumicë serbe, ku ndikimi dhe veprimet e qeverisë serbe vazhdojnë ta cenojnë autoritetin e Kosovës mbi territorin e saj", thuhet në raport.
"Na ka bërë përshtypje të madhe roli që ka luajtur shoqëria civile në Kosovë gjatë vitit të fundit", tha Karppi, duke shtuar se ajo mund të luajë një rol aktiv edhe në zgjidhjen e situatës me Serbinë. "Shohim se janë dy persona që e drejtojnë këtë proces: Kryeministri Albin Kurti dhe presidenti serb Aleksandër. Mendoj se BE-ja mund të bëjë shumë më tepër që në drejtimin e këtyre negociatave të sjellë në procesin e negociatave zërat e shoqërisë civile dhe perspektivën e qytetarëve të zakonshëm, veçanërisht atyre në veri", thotë Karppi.
Raporti përmend edhe mungesën e suksesit në negociatat mes kryeministrit të Kosovës Albin Kurti dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq, me gjithë përpjekjet e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara.




## Ballkani Perëndimor, mes shpresës dhe zhgënjimit

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, joanëtare të BE-së, ishin regjime hibride/demokraci në tranzicion dhe institucionet demokratike vazhduan të ishin të brishta në vitin 2022. Sipas raportit, në vendet e Ballkanit Perëndimor zërat e shoqërisë civile dhe qytetarëve janë përjashtuar. "Në gjithë Ballkanin Perëndimor politika e përqendruar tek elitat dhe diplomacia ka përjashtuar zërat e shoqërisë civile dhe qytetarëve të thjeshtë, duke lejuar që udhëheqës antidemokratikë dhe autoritarë kontrollojnë të ardhmen e vendit", thuhet në raport.
Përmirësimet modeste në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut ishin në baraspeshë me rëniet në Mal të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinë, ndërsa rezultati i Serbisë mbeti i pandryshuar.
Megjithëse rezultatet në raport e vendosin Shqipërinë pranë Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi në aspektin e zhvillimit demokratik, sondazhet sugjerojnë se shqiptarët janë më shumë optimistë se anëtarësimi në BE do të ofrojë jo vetëm mirëqenie ekonomike, por edhe përmirësim të standardeve demokratike.
Alexandra Karppi e organizatës Freedom House thotë se angazhimi i shtuar i BE-së dhe ShBA-së si në bisedimet Kosovë - Serbi, edhe më gjerë në rajon, është diçka pozitive. "Megjithatë këto janë procese të drejtuara nga elita që mund të bëjnë më shumë për ta pasqyruar perspektivën e qytetarëve dhe aktorëve joqeveritarë", thotë ajo.
Qytetarët e vendeve kandidate të BE-së vazhduan ta mbështetin në masën më të madhe anëtarësimin në bllok, megjithatë ata dyshojnë se anëtarësimi do të vijë së shpejti. Serbët janë një përjashtim i qartë, me skepticizmin më të lartë për përfitimet nga anëtarësimi.
Sipas raportit, mungesa e shpresës ka kontribuar në eksodin nga rajoni. Një e pesta e të lindurve në Ballkanin Perëndimor janë larguar nga vendet e tyre.
Raporti sugjeron nevojën e një riangazhimi energjik nga BE-ja për integrimin dhe paralajmëron se braktisja nga Perëndimi hap rrugën për ndërhyrje dhe ndikim nga fuqitë autoritare. "Kjo shihet nga përpjekjet e vazhdueshme të Moskës për ta përhapur dezinformim dhe krijuar lidhje politike në rajon", thuhet në raport.
Por Freedom House thekson se janë udhëheqësit e vendeve që duhet ta sjellin përparimin demokratik për qytetarët e tyre.

## Krasniqi: Krenar me qeverisjen komunale të PDK-së



**Prishtinë, 24 maj** - Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se komuna e Skenderajt, e qeverisur nga kryetari Fadil Nura dhe ekipi i tij, janë shpallur kampionë të Kosovës në Indeksin e Transparencës për vitin 2022, në raportin e fundit të Institutit Demokratik të Kosovës. "Në mesin e dhjetë komunave më transparente dhe efikase janë edhe pesë komuna të tjera të qeverisura nga PDK-ja, Mitrovica, Prizreni, Drenasi, Ferizaj dhe Hani i Elezit. Ndërkaq, në pjesën e parë të tabelës për qeverisje të mirë janë edhe Kaçaniku e Vushtrria. Kjo është ajo që kemi premtuar dhe sot jam tejet i lumtur dhe krenar që kryetarët e komunave ku qeverisim ne, po përmbushin premtimet dhe vizionin tonë qeverisës: Transparent, profesional dhe në shërbim të qytetarëve", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".
Ai i ka falënderuar kryetarët dhe ekipet e tyre në Skenderaj, Mitrovicë, Prizren, Drenas, Ferizaj, Han të Elezit, Kaçanik dhe Vushtrri për punën e mirë gjatë vitit të kaluar. "Le të jetë ky vetëm fillimi për një mandat efikas dhe që do t'i përmirësojë ndjeshëm komunat që ne qeverisim dhe jetën qytetarëve tanë që jetojnë aty", ka theksuar Krasniqi.

FLET PËR "EPOKËN E RE" I AKREDITUARI I GJYKATËS SPECIALE, SKËNDER MUSA

# Gjykata Speciale është duke e tepruar me seanca të mbyllura

- Nuk ka logjikë që të gjithë dëshmitarët të dëgjohen në seanca të mbyllura
- Edi Rama është duke bërë një punë të shkëlqyeshme në favor të vërtetimit të pafajësisë së krerëve të UÇK-së

Avokati i akredituar i Gjykatës Speciale, Skënder Musa, ka vlerësuar se Gjykata Speciale është duke e tepruar me mbajtjen e seancave të mbyllura në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së. Musa në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se nëse vazhdohet me seanca të tilla, Specialja rrezikon ta shkelë parimin e publicitetit. Ndërsa sa i përket kohëzgjatjes së këtij procesi gjyqësor, avokati Musa ka thënë se nuk do të zgjasë aq sa ka planifikuar ZPS-ja. Duke iu referuar provave të ZPS-së, Musa ka vlerësuar se në fund të këtij procesi liderët e UÇK-së do të shpallen të pafajshëm. Krahas kësaj, ai e ka kritikuar heshtjen e institucioneve të Kosovës karshi Speciales dhe ka lavdëruar angazhimin e shtetit shqiptar dhe kryeministrin Edi Rama për mbrojtje të UÇK-së



EPOKA E RE Lirim GECI

PRISHTINË, 24 MAJ - Avokati i akredituar i Gjykatës Speciale, Skënder Musa, ka kritikuar Gjykatën Speciale në lidhje me procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Musa ka thënë se kjo gjykatë është duke e tepruar me mbajtjen e seancave të mbyllura për publikun. "Megjithatë mendoj se këta e kanë tepruar me mbylljen e këtyre seancave. Nuk ka logjikë që të gjithë dëshmitarët të dëgjohen në seanca të mbyllura", ka thënë Musa. Në këtë kontekst, Musa ka thënë se nëse vazhdohet me seanca të tilla, Gjykata Speciale rrezikon ta shkeël parimin e publicitetit. "Nëse vazhdohet me mbajtjen e seancave me dyer të mbyllura do të kemi shkelje të parimit të publicitetit dhe shkelje të të drejtave të qytetarëve të Kosovës dhe të qytetarëve të tjerë që pretendojnë se janë viktima në luftën e Kosovës për shkak se të gjithë qytetarët kanë të drejtë të kenë njohuri se çfarë është duke ndodhur me këtë proces gjyqësor", ka deklaruar Musa.

Ndërsa sa i përket kohëzgjatjes së këtij procesi gjyqësor, Musa ka thënë se ky proces nuk do të zgjasë aq sa ka planifikuar Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS).

Avokati Musa ka vlerësuar se në fund të këtij procesi gjyqësor liderët e UÇK-së do të shpallen të pafajshëm. "Natyrisht pres lirimin e të gjithë ushtarëve të UÇK-së, duke përfshirë këtu edhe krerët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së", ka thënë Musa.

Më tutje, avokati Musa ka kritikuar edhe qasjen e institucioneve të Kosovës në raport me liderët e UÇK-së ndaj të cilëve tashmë ka filluar procesi gjyqësor. "Heshtja e institucioneve të Kosovës është e pakuptimtë për shkak se ky proces gjyqësor është tepër i rëndësishëm për shtetin e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës pasi i akuzuar është njeriu që e ka udhëhequr Shtabin e Përgjithshëm dhe njeriu që e ka shpallur pavarësinë e Kosovës. Thjesht, janë në pyetje aktorët kryesorë të luftës, të cilët janë të akuzuar dhe është totalisht e paarsyeshme heshtja e institucioneve të Kosovës karshi këtij procesi të padrejtë gjyqësor që është duke u zhvilluar kundër luftëtarëve të UÇK-së", është shprehur Musa.

Derisa i ka kritikuar institucionet e Kosovës, avokati Musa ka vlerësuar lart angazhimin e shtetit shqiptar dhe të kryeministrit Edi Rama.

Musa ka thënë se Rama është duke bërë punë të shkëlqyeshme në mbrojtje të luftës së UÇK-së. "Kryeministri Edi Rama është duke bërë një punë të shkëlqyeshme në favor të vërtetimit të pafajësisë së krerëve të UÇK-së. Ai është duke luftuar me mjete politike që të dalë e vërteta në shesh. Në fakt, krerëve të UÇK-së nuk ka nevojë t'u ndihmojë askush. Ata kanë nevojë që vetëm Gjykata Speciale të jetë e drejtë dhe këtë janë duke e bërë shumë mirë Edi Rama, Kuvendi, Qeveria dhe Presidenca e Shqipërisë", ka thënë Musa.

**"Epoka e re":** *Z. Musa, si jeni duke e parë procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në Hagë ndaj liderëve të UÇK-së, duke pasur parasysh se shumica e seancave janë duke u mbajtur të mbyllura për publikun?*

**Musa:** Procesi gjyqësor në Hagë që nga fillimi i hetimeve është përcjell me zvarritje të shumta. Pa asnjë dyshim çdo zvarritje dërgon në shkeljen e të drejtave të të dyshuarve, respektivisht të të akuzuarve. Është mirë që ka filluar procesi gjyqësor dhe ka ardhur në pyetje marrja e provave përmes dëshmitarëve që padyshim janë prova të rëndësishme. Mirëpo forma se si janë duke u marrë në pyetje dëshmitarët, në seanca të mbyllura, tregon se prokurori ka parashtruar kërkesa të shumta në mënyrë që dëshmitarëve të mos u zbulohet identiteti për shkak të, kinse, rrezikimit të tyre.

**"Epoka e re":** *Si avokat i akredituar në Gjykatën Speciale, çfarë do të thotë për kredibilitetin e kësaj gjykate mbajtja e seancave të mbyllura për publikun?*

**Musa:** Mbajtja e seancave të mbyllura parashihet me aktet ligjore të Kosovës, duke përfshirë edhe Ligjin për Dhomat e Specializuara. Në aspektin ligjor, seancat e mbyllura mbahen vetëm kur dëshmitarit i rrezikohet jeta, shëndeti etj. Mirëpo në rastin konkret është e pamundshme që të gjitha këto seanca, pothuajse të gjithë dëshmitarët, të jenë të atillë që mund t'u rrezikohet jeta e tyre, shëndeti apo jeta familjare e tyre. Nëse vazhdohet me mbajtjen e seancave me dyer të mbyllura, do të kemi shkelje të parimit të publicitetit dhe shkelje të të drejtave të qytetarëve të Kosovës dhe të qytetarëve të tjerë që pretendojnë se janë viktima në luftën e Kosovës për shkak se të gjithë qytetarët kanë të drejtë të kenë njohuri se çfarë është duke ndodhur me këtë proces gjyqësor. Parimi i publicitetit është i rregulluar dhe garantuar me kode, me Kodin e Procedurës Penale dhe me konventat ndërkombëtare. Kjo vlen nëse gjykata nuk arrin ta argumentojë mjaftueshëm se është e nevojshme që seancat të mbahen të mbyllura për dëshmitarë të caktuar. Megjithatë mendoj se këta e kanë tepruar me mbylljen e këtyre seancave. Nuk ka logjikë

që të gjithë dëshmitarët të dëgjohen në seanca të mbyllura.

**"Epoka e re":** *Z. Musa, deri më tani janë marrë në pyetje vetëm shtatë dëshmitarë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Në këtë kontekst, duke iu referuar numrit të madh të dëshmitarëve të ZPS-së, sa prisni që të zgjasë ky proces?*

**Musa:** Procesi nuk do të zgjasë aq sa e ka planifikuar ZPS-ja. Kur e them këtë bazohem në praktikat gjyqësore vendore dhe ndërkombëtare. Zakonisht dëshmitarët që janë më të rëndësishëm merren në fillim në pyetje, ndërsa dëshmitarët e tjerë mund të jenë më pak të rëndësishëm edhe pse nuk do të thotë se Specialja i zbaton praktikat gjyqësore të Kosovës apo të gjykatave ndërkombëtare. Mund të ndodhë që ka dëshmitarë të rëndësishëm, sipas prokurorisë, kah mesi dhe fundi. Në bazë të praktikave gjyqësore, zakonisht dëshmitarët që janë si më kryesorët merren në pyetje në fillim, sepse prokurori me ata dëshmitarë pretendon ta vërtetojë aktakuzën. Dhe nëse është kjo praktikë që ne e njohim, mund të them se prokuroria ka dështuar se këta dëshmitarë nuk kanë arritur të vërtetojnë diçka substanciale në aktakuzë, sipas mendimit tim si avokat. Ata më shumë janë marrë me çështje të tjera penale sesa kanë paraqitur ndonjë njohuri mbi pretendimet që përshkruhen në aktakuzë dhe veprat për çfarë akuzohen ish-krerët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.



**"Epoka e re":** *Duke iu referuar aktakuzës, konkretisht pjesës që është bërë publike, cili prisni që do të jetë epilogu i këtij procesi gjyqësor?*

**Musa:** Paragjykimi i procesit gjyqësor nuk është nga ana e avokatëve ose juristëve, por ne kemi të drejtë ta shprehim mendimin tonë për procesin gjyqësor. Duke pasur parasysh se çfarë provash janë deponuar dhe çfarë dëshmitarësh janë dëgjuar deri më tani, dhe duke i njohur mirë zhvillimet e luftës në Kosovë, ku kam qenë në Kosovë gjatë gjithë periudhës së luftës dhe duke qenë i sigurt se Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) nuk ka kryer krime lufte, sepse nuk ka pasur mundësi, besoj shumë se në fund Dhomat e Specializuara do të marrin vendim të drejtë. Natyrisht presë lirimin e të gjithë ushtarëve të UÇK-së, duke përfshirë këtu edhe krerët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

**"Epoka e re":** *Z. Musa, kur jemi te procesi gjyqësor, si jeni duke i parë veprimet e institucioneve të Kosovës karshi këtij procesi?*

**Musa:** Në aspektin ligjor dhe formal institucionet e Kosovës nuk kanë të drejtë të përzihen në punën e drejtësisë, mirëpo duke pasur parasysh se Gjykata Speciale është gjykatë ndërkombëtare, heshtja e institucioneve të Kosovës është e pakuptimtë për shkak se ky proces gjyqësor është tepër i rëndësishëm për shtetin e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës, sepse i akuzuar është njeriu që e ka udhëhequr Shtabin e Përgjithshëm dhe njeriu që e ka shpallur pavarësinë e Kosovës. Thjesht, janë në pyetje aktorët kryesorë të luftës të cilët janë të akuzuar dhe është totalisht e paarsyeshme heshtja e institucioneve të Kosovës karshi këtij procesi të padrejtë gjyqësor që është duke u zhvilluar kundër luftëtarëve të UÇK-së.

**"Epoka e re":** *Nga kjo që thoni Shqipëria dhe kryeministri Edi Rama është në nivel të detyrës kur është në pyetje Gjykata Speciale dhe liderët e UÇK-së?*

**Musa:** Padyshim, kryeministri Edi Rama është duke bërë një punë të shkëlqyeshme të favor të vërtetimit të pafajësisë së krerëve të UÇK-së. Ai është duke luftuar me mjete politike që të dalë e vërteta në shesh. Në fakt, krerëve të UÇK-së nuk ka nevojë t'u ndihmojë askush. Ata kanë nevojë që vetëm Gjykata Speciale të jetë e drejtë dhe këtë janë duke e bërë shumë mirë Edi Rama, Kuvendi, Qeveria dhe Presidenca e Shqipërisë. Në këtë drejtim, Shqipëria është duke e luajtur rolin shumë pozitiv, shumë më pozitiv se Kosova. Institucionet e Kosovës, për mendimin tim, nuk janë duke e dhënë asnjë ndihmë, me përjashtim të pagesave për avokatët mbrojtës.

# Kosova shpall të mbyllur emergjencën me Covid-19

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 24 MAJ** - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për mbyllje të emergjencës së shëndetit publik pas tre vitesh betejë me pandeminë Covid-19. Kërkesën për mbyllje të kësaj gjendjeje e bëri ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, gjatë mbledhjes së qeverisë të mërkurën, ku tha se institucioni që ai drejton ka marrë parasysh situatën epidemiologjike në Kosovë dhe kërkesa e tij bëhet në përputhje me rekomandimin e Institutit Kombëtar për Shëndetin Publik dhe deklaratën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh-së).

OBSH më 5 maj, duke theksuar tendencën në rënie të vdekjeve nga Covid-19 në gjithë botën, si dhe nivelet e larta të imunizimit të qytetarëve ndaj sëmundjes, këshilloi se është koha për të kaluar në menaxhimin afatgjatë të pandemisë. "Drejtori i përgjithshëm i OBSh-së përcakton se Covid-19 tani është një çështje shëndetësore e vazhdueshme që nuk përbën më një emergjencë të shëndetit publik me shqetësim ndërkombëtar", thuhet në deklaratën e OBSh-së të cilën e përmendi ministri Vitia.




Kosova kishte shpallur emergjencë të shëndetit publik në mes të muajit mars të vitit 2020. Shpallja e kësaj gjendjeje krijoi mekanizma për të ofruar ndihmë të koordinuar qeveritare për qytetarët. "Natyrisht, Ministria e Shëndetësisë me institucionet e tjera përgjegjëse do të vazhdojnë të përcjellin nga afër dhe me shumë kujdes situatën epidemiologjike në vend dhe në përputhje me këtë do të marrin të gjitha veprimet e nevojshme në të ardhmen", ka thënë Vitia.

Në Kosovë deri sot 3 217 persona kanë vdekur si pasojë e Covid-19 dhe 273 934 të tjerë janë prekur nga virusi.

Kryeministri Albin Kurti në këtë mbledhje ka thënë se brenda gjashtë muajve nga fillimi i vaksinimit masiv kemi imunizuar 60 për qind të popullatës së targetuar".

Sipas OBSh-së, deri më 15 janar të vitit 2023 në Kosovë janë administruar gjithsej 1 836 901 doza vaksinash.

# PREDIKIMET SHKENCORE TË NAIM KRASNIQIT PO KONFIRMOHEN



Shkruan: Dr. Hajdin ABAZI

Rrallëherë në histori ndodhë që predikimet krejtësisht të reja në shkencë të konfirmohen kaq shpejt sa po nodhë me ato të Naim Krasniqit – për bërthamën e tokës dhe përgjithësisht të trupave me formë sferike, si dhe, tërthorazi, për fushën antimagnetike, aktualisht si parashikim "për mos rrezikim edhe 1000 vite" të tokës nga goditja e asteroideve shkatërrues.

Zakonisht predikimet teorike ju paraprijnë zbulimeve praktike ose konstatimit eksperimental, dhe kjo paraprirje mund të jetë prej shekujsh deri me dekada. Ekzistenca e atomit, si bazament i realiteti, ishte predikuar nga Leukipi (490-430 p.e.s.) dhe Demokriti (460-360) në shekullin e pestë para erës së re,[1] kurse konfirmimi, ose konstatimi i ekzistencës së atomit si entitet fizik u bë me veprën e John Dalton *A New System of Chemical Philosophy* (1808-1827)[2], dhe sot atomi është një antitet i pranuar. Një tjetër predikim teorik ishte ai i bozonit Higgs[3], i bërë në vitin 1964, konfirmimi eksperimental i të cilit u bë më 4 korrik 2012 nga ekipi i Large Hadron Collider[4].

Zhvillimi i teknologjisë dhe avancimi i saj e kanë shkurtuar përgjithësisht kohën nga parashtrimi teorik deri te konfirmimi eksperimental. Kjo dëshmohet edhe në rastin e predikimeve teorike të fizikanit Naim Krasniqi.

## Trupat qiellor sferik kanë nga dy bërthama

Naim Krasniqi në publikimet e vitit 2019 kishte bërë një predikim krejtësisht të pazakonshëm dhe shumë të pabesueshëm. Ai kishte pohuar se trupat qiellor që kanë formë sferike kanë nga dy bërthama, të cilat janë të integruara: bërthamën e ciklonit dhe bërthamën e tornados elektrostatike që ndodhet brenda saj, e që autori i quan bërthamë ciklo-elektrostatike.

Ja se si shkruante atëherë Naim Krasniqi:

"Forca tërheqëse e bërthamës së ciklonit të tokës e ka tërhequr rreth vetes bërthamën e tornados elektromagnetike e cila ishte më afër. Në këtë mënyrë, pas një kohe, bërthama e tornados elekotromagnetike përfundon në brendësi të sferës feromagnetike me rreze prej 3846 km, në qendër të së cilës ndodhet bërthama e ciklonit."[5]

Në librin "Mikrobota..." që doli nga shtypi më 4 shkurt 2023, Naim Krasniqi e shpjegon më tej fenomenin e integrimit të këtyre dy fenomeneve bazike:

"Në momentin kur bashkohet bërthama e ciklonit me bërthamën e tornados elektrostatike formohet bërthama e përbashkët që quhet bërthama cikloelektrostatike (bce)"[6].

Fizikani Naim Krasniqi shpjegon në detaje se si është krijuar kjo bërthamë e integruar, dhe kjo ndodhte në vitet kur shkencëtarët pohonin se toka kishte një bërthamë të vetme. Rreth pesë vite më pas, më 23 shkurt 2023 një grup shkencëtarësh, me anë të matjeve sizmike, demonstron ekzistencën e një bërthamë tjetër brenda asaj bërthame të brendshme të tokës[7] që besohej se ishte e vetmja. Njëri nga këta shkencëtarë shkruan: "Ne e kemi konfirmuar tani ekzistencën e një bërthame më të brendshme në brendësi të bërthamës"[8]. Sigurisht, referimi "konfirmim" i adresohet dy shkencëtarëve të tjerë, përkatësisht hipotezës së tyre të shtruar në vitin 2002[9].

Ajo që e dallon predikimin teorik të shkencëtarit Naim Krasniqi është fakti se ai e shpjegon jo vetëm se Toka, por edhe çdo trup tjetër qiellor me formë sferike, ka bërthamën e ciklonit dhe brenda saj e ka bërthamën e tornados elektrostatike. Ai e zbërthen enigmën: "gjatë bashkëveprimit të atomeve të elementeve (aX) dhe (aY) formohen ciklonet, kurse për ndryshim nga ciklonet, tornadot formohen gjatë bashkëveprimit të atomeve të elementeve të (aX) dhe (aZ), çka do të thotë se sikur ciklonet ashtu edhe tornadot kanë një element të përbashkët (aX)"[10].


FEJTON
Fizika simetrike, udhëtim drejt universit

Jo më larg se në muajin maj 2023 u konfirmua se edhe Hëna e ka një bërthamë të brendshme[11], [12]. Nisur nga këto konfirmime eksperimentale për bërthamën brenda bërthamës së Tokës dhe të Hënës mund të pohohet se nuk do të jetë e largët dita kur kolegët shkencëtarë do të arrijnë të konstatojnë se edhe dielli ynë, dhe çdo trup qiellor që ka formë sferike, ka një bërthamë të dyfishtë, përkatësisht bërthamën e ciklonit dhe brenda saj të integruar edhe bërthamën elektrostatike.

## Toka nuk rrezikohet nga goditja e asteroidëve

NASA, në portalin e saj zyrtar, pohon se vetëm një herë në disa miliona vite mundet një asteroid ta godasë tokën sa të rrezikojë njerëzimin[13].

Studimet e ndryshme shkencore kanë konstatuar se afërsisht para 66 milionë vitesh, ishte goditja e një asteroidi ai që i dha fund epokës së dinozaurëve, dhe e shoi 80% të jetës në planetin tonë[14]. Nga ky pohim ishin ngjallur parashikimet për rreziqet për Tokën nga goditja prej asteroideve. Në vitin 2019, Naim Krasniqi kishte shkruar se jepen "informata të frikshme dhe të pavërteta mbi rrezikimin e Tokës nga goditjet e trupave të tjerë qiellorë"[15].

Këtyre ditëve u deklarua me një siguri shumë të madhe se asnjë asteroid shkatërrues nuk do ta godas Tokën në 1000 vitet e ardhshme[16], [17]. Ky konstatim u bazua në shkrimin autorial të katër shkencëtarëve, publikuar në Draft-versionin e 9 maj 2923[18].

David Fornacchia, nga Qendra e NASA-s për studimin e objekteve afër Tokës, ndër të tjera, pohoi, se "Në përgjithësi, ndikimet asteroide të afta për të shkaktuar dëme të konsiderueshme në Tokë janë jashtëzakonisht të pamundura"[19].

Një pohim të këtillë e kishte bërë me siguri shumë të madhe edhe fizikani Naim Krasniqi në vitin 2019.

## Kush e mbron Tokën nga goditjet e asteroideve?

Shpjegimet janë të ndryshme. Astrofizikanët kryesisht theksojnë lëvizjet orbitale të sistemit tonë diellor, si dhe lëvizjen e asteroidëve.

Për parashikimin e lëvizjeve të asteroideve NASA ndjek këtë model:

"Orbita e një asteroidi llogaritet duke gjetur shtegun eliptik rreth diellit që i përshtatet më mirë vëzhgimeve të disponueshme të objektit. Kjo do të thotë, shtegu i llogaritur i objektit rreth diellit rregullohet derisa parashikimet se ku duhet të ishte shfaqur asteroidi në qiell në disa momente të vëzhguara përputhen me pozicionet ku objekti u vëzhgua në të njëjtën kohë. Ndërsa gjithnjë e më shumë vëzhgime përdoren për të përmirësuar më tej orbitën e një objekti, ne bëhemi gjithnjë e më të sigurt në njohuritë tona se ku do të jetë objekti në të ardhmen.[20]" Madje NASA ka lansuar një aplikaci9n ku mund të përcillen lëvizjet e asteroideve.

Por Naim Krasniqi nxherrë shkaqet elementare të mekanizmit mbrojtës të Tokës. Ai shkruan: "Kur sulmohemi, si sulmohemi dhe kush është faktori kryesor që na mbron neve në tokë dhe e mban stabil universin nga shkatërrimi... Kjo forcë që e mban stabil universin ka një emër dhe një burim"[21]. Ajo është fusha antimagnetike[22], e cila vepron me forcë shtytëse, ose anti-gravitacionale[23] e të cilën e ka zbuluar Naim Krasniqi[24]. Fusha antimagnetike është e vetmja forcë shtytëse në univers dhe pikërisht kjo është ajo që edhe e bën të mundur ekzistencën e sistemeve diellore, dhe të galaktikave[25].

Dhe konkretisht ajo është mburojë e tokës: "Fusha antimagnetike që buron nga toka është e vetmja forcë që e parandalon goditjen e Tokës nga Hëna, e mbron Tokën nga goditjet e trupave të tjerë qiellorë qoftë nga meteorë apo asteroide..., e mbron Tokën nga rrezatimet e ndryshme, sidomos nga erërat vdekjeprurëse të Diellit..."[26].


FEJTON
Efektet e fushës antimagnetike (antigravitacionale ((-G)) të tokës

Sa i përket Hënës, shkencëtari Naim Krasniqi shkruan: "Hëna nuk ka fushë magnetike të fortë por vetëm një magnetizim të padukshëm nga Toka, prandaj nuk mundet të ketë fushë antimagnetike, ky është argumenti që rreth Hënës nuk rrotullohen trupa të tjerë qiellorë, por as nuk mbrohet nga goditja e trupave qiellorë, prandaj është e rrezikuar, sepse kohë pas kohë bien trupa mbi sipërfaqen e Hënës"[27].

Me fjalë të tjera, është fusha antimagnetike, përkatësisht forca e saj shtytëse e cila e mbron Tokën nga goditjet e trupave qiellorë, madje, në një kontekst më të gjerë, edhe vetë Diellin, dhe tërë vetë galaktikat.

## Po si ndodhë atëherë që, megjithatë, ndonëse rrallë, të goditet Toka nga asteroide?

Mbrojtja e Tokës nga fusha antimagnetike është një mbrojtje e natyrshme, një mekanizëm i vetë trupave qiellore si yje, planetë etj. Është forca e saj shtytëse ajo që i shërben si mburojë trupave qiellorë si Toka. Por kjo mbrojtje nuk është absolute.

Duke u bazuar në teorinë e Naim Krasniqit mbi fushën antimagnetike, mund të thuhet se si fusha magnetike ashtu edhe fusha antimagnetike nuk janë konstante universale te secili trup qiellor. Tërë kohën janë në ndërveprim fushat magnetike dhe antimagnetike, përkatësisht forcat tërheqëse me forcën shtytëse. Është një proces i çdo hershëm. Dhe në këtë proces konstelacionet midis këtyre forcave ndodhë, nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm, të mos jene të njëjta, po të ndryshojnë në ndonjë rast. Raste të këtilla, fjala vjen, mund të jenë lëvizja e poleve magnetike të trupit qiellor, me ç'rast lëvizin edhe fusha magnetike dhe antimagnetike. Mund të jetë ndonjë konstelacion i brendshëm midis bërthamës së ciklonit dhe të tornados elektrostatike, që shkakton ndonjë dobësim të përkohshëm të fushës antimagnetike. Mund të jetë edhe nëse, në ndonjë rrethanë, fushat tërheqëse nga Dielli janë të përqendruara në një kah të caktuar ndaj Tokës, me ç'rast fusha e saj antimagnetike mund të jetë po ashtu më e përqendruar në atë drejtim, dhe disi më ë dobët në ndonjë drejtim tjetër. Pra, për shkaqe të ndryshme, mundet të dobësohet në ndonjë segment fusha natimagnetike. Po qe se në një rrethanë të këtillë të ndodhet ndonjë asteroid pikërisht në atë konstelacion, atëherë ai mund të rastis të godasë në pikën e dobët të fushës antimagnetike, pra të forcës shtytëse, dhe pikërisht në këtë dimension të dobësuar mbrojtës të mund të depërtojë dhe të godasë Tokën, respektivisht cilindo qoftë trup qiellor sferik.

## Astrofizika dhe shkencat e natyrës ndodhen para konfirmimeve të mëdha shkencore

Astrofizika duket se është duke bërë hapa në drejtimin për të arritur të një konfirmim i madh shkencor. Po e quaj konfirmim, pasi që teorikisht e ka zbuluar atë teoricieni i fizikës Naim Krasniqi. E kam fjalën për fushën antimagnetike në makrobotë por edhe fushën antielektrostatite në mikrobotë. Naim Krasniqi e ka treguar me eksperimente mekanike burimin e fushës antimagnetike, fushë e cila ka karakter shtytës ose antigravitacional, pra i kundërt me forcën tërheqëse. Ajo është një lloj konvertimi i fushës magnetike në fushë antimagnetike, dhe ndodhë vetëm atëherë kur polet e magnetit mbulohen me shtresën ferromagnetike, e atëherë fusha që shpërthen në drejtimet ekuatoriale merr karakteristika krejt të kundërta, duke u bërë forcë shtytëse.

Por, po kaq i madh do të jetë edhe konfirmimi i gjenerimit të fushës tërheqëse (gravitacionale) dhe fushës anti-elektrostatike (shtytëse) në mikro dhe në makro botë, membranës radioaktive të bërthamës së atomit dhe të grimcave të atomit, dhe shumë zbulimeve të tjera teorike që Naim Krasniqi i parashtroi në librin e tij *Mikrobota*.

---

1 Samuel Enoch Stumpf, *Filozofia, Historia & problemet*, Botimet Toena, Tiranë, ISBN 99927-1-259-7, f. 24-27.

2 John Dalton, A New System of Chemical Philosophy - Science History Institute Digital Collections.

3 Hajdin Abazi, *Shkenca në ( r) evolucion. Refleksione mbi kërkimin, arritjet, teknlogjinë, sfidat dhe transformimet shkencore*, Kolegji AAB, Prishtinë, 2008, f. 65-67.

4 The Higgs boson | CERN (home.cern)

5 Naim Krasniqi, Gazeta "Epoka e re", 17 korrik 2019, f. 11.

6 Naim Krasniqi, *Mikrobota, më ndryshe - një strukturë shumë më ndryshe e atomit*, N. Sh. Armagedon, Prishtinë, 2023, f. 107

7 Kenneth Chang, What's Inside Earth's Inner Core? Seismic Waves Reveal an Innermost Core. - The New York Times (nytimes.com).

8 Ibid.

9 Iaki Ishii and Adam M. Dziewoński The innermost inner core of the earth: Evidence for a change in anisotropic behavior at the radius of about 300 km | PNAS / e

10 Naim Krasniqi, Gazeta "Epoka e re", 16 korrik 2019, f. 11..

11 We Know What's Inside The Moon; Scientists Make a Discovery (interestingengineering.com)

12 NASA - NASA Research Team Reveals Moon Has Earth-Like Core

13 Asteroid Fast Facts | NASA

14 Here's What Happened the Day the Dinosaurs Died (nationalgeographic.com)

15 Naim Krasniqi, "Epoka e re", 16 korrik 2019, f. 11.

16 Jonathan O'Kallaghan, Earth is probably safe from a killer asteroid for 1,000 years | MIT Technology Review, May 15, 2023.

17 NASA bën matematikat: Ja për sa vite është Toka e sigurt nga asteroidët - Gazeta Express

18 Oscar Fuentes-Muñoz, Daniel J. Scheeres, Davide Farnocchia, Ryan S. Park, [2305.04896] The hazardous km-sized NEOs of the next thousands of years (arxiv.org)

19 Richard Currie, World-ending asteroid will not hit Earth in next 1,000 years • The Register , May 17, 2023.

20 Asteroid Fast Facts | NASA

21 Naim Krasniqi, "Epoka e re", 16 korrik 2019, f. 11.

22 Naim Krasniqi, "Epoka e re", 28 korrik 2019, f. 11.

23 Hajdin Abazi, 7-HSS-542.pdf (ijl-rhss.com), 2019.

24 Hajdin Abazi, The Symmetric Physics - a Substantially New Science, Lambert Academic Publishing, 2020, f. 63-107.

25 Naim Krasniqi, "Epoka e re", 16 korrik 2019, f. 11.

26 Naim Krasniqi, "Epoka e re", 24 korrik 2019, f. 11.

27 Ibid.

# KDI-ja publikon indeksin vjetor të transparencës në qeverisjen komunale, Skenderaj i pari

EPOKA E RE
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 MAJ - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në bashkëpunim me Transparency International Slovakia dhe mbështetjen financiare të SlovakAid, ka publikuar të mërkurën Indeksin e Transparencës për Qeverisjen Komunale për vitin 2022. Komunat janë vlerësuar në 87 indikatorë për tetë shtylla: 1) transparenca në shpenzimet publike përmes prokurimit publik, 2) transparenca buxhetore, 3) transparenca në grantet dhe subvencionet komunale, 4) përfshirja e qytetarëve në vendimmarrjen komunale, 5) qasja në dokumente publike, 6) përgjegjshmëria e komunave për t'i adresuar risqet e korrupsionit dhe konfliktin e interesit, 7) menaxhimi i pronës komunale, si dhe 8) transparenca e ndërmarrjeve dhe organizatave publike në pronësi të komunave.

Diana Metushi-Krasniqi, menaxhere e projektit në KDI, gjatë prezantimit të gjetjeve kryesore të raportit tha se është për t'u vlerësuar fakti se komunat nga viti në vit po dëshmojnë se janë më të përgjegjshme për publikimin e informatave dhe dokumenteve për publikun, duke shënuar rritje të nivelit të transparencës nga 56 për qind në vitin 2021 në 68 për qind në vitin 2022, megjithatë uebfaqet e komunave po vazhdojnë të jenë shpesh të paqasshme si rezultat i problemeve teknike. Sipas saj, kjo i zbeh përpjekjet e komunave për transparencë, ndërkohë që i dekurajon qytetarët të qasen në informacione dhe të kërkojnë llogaridhënie nga komunat e tyre.

Ajo ka theksuar se për shkak që nuk po gjendet një zgjidhje për ta standardizuar emërtimin dhe publikimin e dokumenteve publike, qytetarët e kanë të vështirë të arrijnë ta gjejnë informacionin e kërkuar për një kohë të shkurtër në uebfaqe.

Në publikim theksohet se iniciativa e KRPP-së që t'i ndërlidhë njoftimet e komunave lidhur me shpalljen e tenderëve dhe dhënien e kontratave me platformën eProkurimi ishte faktori kryesor që ndikoi në rritjen e transparencës në politikat e prokurimit publik. Megjithatë, duhet të bëhen përpjekje nga pushteti lokal për ta rritur transparencën në raport me ndërmarrjet publike që menaxhohen nga komunat, me theks krijimin e instrumenteve për mbrojtjen e integritetit dhe raportimin e sjelljeve joetike.

Po ashtu, kërkohet që komunat të dalin me ide e forma më të reja për ta rritur pjesëmarrjen e publikut në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes. Katër komunat në veri të Kosovës nuk kanë publikuar asnjë dokument në uebfaqet zyrtare.

Indeksi i transparencës në qeverisjen komunale për vitin 2022 e rendit komunën e Skenderajt më transparenten me 92.63 pikë (nga maksimumi prej 100 pikëve në 87 treguesit e matur), pasuar nga komuna e Lipjanit dhe e Mitrovicës të vlerësuara me 91.13 pikë, Prizreni (90.63 pikë), Drenasi (89.88 pikë), Prishtina (89.13 pikë), Rahoveci (88.94), Ferizaj (86.94 pikë), Gjakova (85.38 pikë) dhe Hani i Elezit (83.62 pikë), dhe Dragashi (82.73 pikë).

Pesëmbëdhjetë (15) komunat me rritjen më të lartë të transparencës krahasuar me vitin 2021 janë Skenderaj, Istogu, Deçani, Prizreni, Malisheva, Kamenica, Hani i Elezit, Dragashi, Drenasi, Klina, Juniku, Suhareka, Obiliqi, Lipjani dhe Graçanica.

Në vazhdim Kristina Krokova nga Transparency International - Slovakia ka theksuar se është e mahnitur ta shohë përparimin që komunat në Kosovë po arrijnë nga viti në vit. "Rritja mesatare prej 12-përqindësh nga viti i kaluar është shpresëdhënëse dhe tregon që qeveritë komunale do të mund të bëjnë edhe më shumë deri në fund të mandatit të tyre", ka pohuar ajo.

Krokova ka theksuar se komunat në Sllovaki nuk kanë pasur përparim të përnjëhershëm si në rastin e Kosovës dhe, sipas matjeve të tyre, nga viti 2012 përparimi nuk ka kaluar 25-përqindëshin.

KDI-ja i ka inkurajuar të gjitha komunat të analizojnë ku çalojnë sa i përket matjeve të 2022-s dhe të përkushtohen për t'i përmbushur standardet e transparencës gjatë viteve në vijim. Po ashtu, KDI-ja kërkon nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Agjencia e Shoqërisë së Informacionit që urgjentisht ta rregullojnë çështjen e uebfaqeve të komunës në mënyre që ato të jenë funksionale dhe në shërbim të publikut.



INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS — TRANSPARENCY INTERNATIONAL KOSOVA

INDEKSI I TRANSPARENCËS NË QEVERISJEN KOMUNALE 2022

| # | Komuna / Politika qeverisëse | Prokurimi Publik në nivel komunal | Buxhetimi dhe financat publike | Qasja në dokumente dhe informacionin publik | Pjesëmarrja publike | Grantet dhe Subvencionet | Etika Profesionale dhe Konflikti i Interesit | Menaxhimi i pronës komunale dhe Ankandet | Ndërmarrjet dhe organizatat komunale | Pikët e përmbledhura për komunë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Pikët maksimale | 15 | 15 | 15 | 15 | 10 | 10 | 10 | 10 | 100.00 |
| 1 | Skenderaj | 15.00 | 11.54 | 13.85 | 13.50 | 10.00 | 10.00 | 10.00 | 8.75 | 92.63 |
| 2 | Lipjan | 15.00 | 10.38 | 15.00 | 12.00 | 10.00 | 10.00 | 10.00 | 8.75 | 91.13 |
| 2 | Mitrovicë | 15.00 | 11.54 | 13.85 | 12.00 | 10.00 | 10.00 | 10.00 | 8.75 | 91.13 |
| 3 | Prizren | 15.00 | 11.54 | 13.85 | 13.50 | 10.00 | 8.00 | 10.00 | 8.75 | 90.63 |
| 4 | Drenas | 15.00 | 11.54 | 13.85 | 12.00 | 10.00 | 10.00 | 10.00 | 7.50 | 89.88 |
| 5 | Prishtinë | 15.00 | 11.54 | 13.85 | 12.00 | 10.00 | 8.00 | 10.00 | 8.75 | 89.13 |
| 6 | Rahovec | 15.00 | 10.38 | 12.69 | 13.50 | 11.11 | 10.00 | 10.00 | 6.25 | 88.94 |
| 7 | Ferizaj | 15.00 | 10.38 | 12.69 | 9.00 | 11.11 | 10.00 | 10.00 | 8.75 | 86.94 |
| 8 | Gjakovë | 15.00 | 11.54 | 13.85 | 12.00 | 10.00 | 8.00 | 10.00 | 5.00 | 85.38 |
| 9 | Hani i Elezit | 13.64 | 11.54 | 12.69 | 12.00 | 10.00 | 10.00 | 10.00 | 3.75 | 83.62 |
| 10 | Dragash | 15.00 | 10.38 | 13.85 | 12.00 | 10.00 | 4.00 | 10.00 | 7.50 | 82.73 |
| 11 | Istog | 15.00 | 10.38 | 12.69 | 7.50 | 8.89 | 10.00 | 10.00 | 7.50 | 81.97 |
| 12 | Kaçanik | 13.64 | 11.54 | 12.69 | 9.00 | 10.00 | 10.00 | 10.00 | 5.00 | 81.87 |
| 13 | Kamenicë | 15.00 | 9.81 | 12.69 | 12.00 | 10.00 | 8.00 | 10.00 | 3.75 | 81.25 |
| 14 | Deçan | 15.00 | 9.81 | 12.69 | 7.50 | 8.89 | 8.00 | 10.00 | 8.75 | 80.64 |
| 15 | Suharekë | 15.00 | 9.23 | 12.69 | 9.00 | 7.78 | 8.00 | 10.00 | 8.13 | 79.83 |
| 16 | Junik | 12.27 | 9.23 | 12.69 | 12.00 | 8.89 | 8.00 | 10.00 | 5.00 | 78.08 |
| 16 | Pejë | 15.00 | 10.38 | 12.69 | 9.00 | 10.00 | 6.00 | 10.00 | 5.00 | 78.08 |
| 17 | Vushtrri | 15.00 | 10.38 | 12.69 | 9.00 | 10.00 | 8.00 | 10.00 | 2.50 | 77.58 |
| 18 | Shtime | 13.64 | 9.23 | 12.69 | 12.00 | 10.00 | 6.00 | 10.00 | 3.75 | 77.31 |
| 19 | Gjilan | 14.32 | 9.23 | 12.69 | 9.00 | 8.89 | 8.00 | 10.00 | 2.50 | 74.63 |
| 20 | Klinë | 13.64 | 8.65 | 13.85 | 7.50 | 8.89 | 8.00 | 10.00 | 3.75 | 74.28 |
| 21 | Malishevë | 12.27 | 10.38 | 12.69 | 9.00 | 10.00 | 6.00 | 10.00 | 2.50 | 72.85 |
| 22 | Obiliq | 13.64 | 11.54 | 12.69 | 12.00 | 10.00 | 4.00 | 5.00 | 3.75 | 72.62 |
| 23 | Podujevë | 14.32 | 7.50 | 12.12 | 9.00 | 10.00 | 6.00 | 10.00 | 2.50 | 71.43 |
| 24 | Viti | 13.64 | 8.08 | 12.69 | 6.00 | 10.00 | 2.00 | 10.00 | 2.50 | 64.91 |
| 25 | Mamushë | 13.64 | 9.81 | 12.69 | 6.00 | 5.56 | 2.00 | 5.00 | 3.75 | 58.44 |
| 26 | Fushë Kosovë | 8.18 | 6.92 | 12.69 | 6.00 | 8.89 | 0.00 | 10.00 | 3.13 | 55.81 |
| 27 | Graçanicë | 12.95 | 7.50 | 12.69 | 6.00 | 4.44 | 4.00 | 5.00 | 1.25 | 53.84 |
| 28 | Shtërpcë | 5.45 | 5.77 | 12.69 | 6.00 | 4.44 | 6.00 | 5.00 | 1.88 | 47.24 |
| 29 | Novo Bërdë | 10.91 | 4.62 | 12.69 | 0.00 | 4.44 | 0.00 | 5.00 | 1.88 | 39.54 |
| 30 | Kllokot | 5.45 | 1.15 | 12.69 | 0.00 | 7.78 | 2.00 | 5.00 | 1.25 | 35.33 |
| 31 | Ranillug | 5.45 | 1.15 | 12.69 | 3.00 | 3.33 | 0.00 | 5.00 | 1.25 | 31.88 |
| 32 | Partesh | 5.45 | 1.15 | 10.38 | 0.00 | 3.33 | 2.00 | 0.00 | 1.25 | 23.58 |
| 33 | Leposaviq | 5.45 | 1.15 | 1.15 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 1.25 | 9.01 |
| 33 | Mitrovicë e Veriut | 5.45 | 1.15 | 1.15 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 1.25 | 9.01 |
| 33 | Zubin Potok | 5.45 | 1.15 | 1.15 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 1.25 | 9.01 |
| 33 | Zvecan | 5.45 | 1.15 | 1.15 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 1.25 | 9.01 |

# Kurti: Betimi i kryetarëve të rinj në veri, të enjten në ndërtesa publike

PRISHTINË, 24 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në mbledhjen e qeverisë të mbajtur të mërkurën më 24 maj, ka bërë me dije se kryetarët e rinj të tri komunave të banuara me shumicë serbe, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, do të betohen të enjten. "Nesër në ndërtesa publike në këto komuna do të mbahen seanca konstituive dhe [do të bëhet] betimi i tre kryetarëve të rinj", tha kryeministri, pa përmendur se për çfarë ndërtesash bëhet fjalë.

Por, kryetari i zgjedhur i komunës së Zveçanit, Ilir Peci, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se ceremonia e betimit solemn të tij do të mbahet në fshatin Boletin, në objektin "Kulla e Isë Boletinit".

Betimin solemn, kryetari i ri i Leposaviqit, Lulzim Hetemi, do ta bëjë në fshatin Bistricë, në objektin e Shkollës Fillore "Kadri Bistrica".

Kryetari i ri i Zubin Potokut, Izmir Zeqiri, do ta bëjë betimin solemn në fshatin Çabër të kësaj komune, në objektin e zyrës komunale për komunitete.

Derisa komuna e Mitrovicës së Veriut ka objektin e saj, në tri komunat e tjera deri më tash në të njëjtat objekte komunale kanë punuar institucionet komunale sipas sistemit të Kosovës, por edhe të ashtuquajturat organe të përkohshme të cilat punojnë sipas sistemit të Serbisë.

Në anën tjetër, vetëm Zubin Potoku e ka asamblenë komunale funksionale, ndërsa dy komunat e tjera, Leposaviqi dhe Zveçani, ende nuk i kanë të funksionalizuara ato. Mirëpo konstituimi i kuvendeve komunale do të bëhet në të njëjtat objekte ku do të zhvillohet ceremonia e betimit.



Kryetarët e komunave nuk mund ta kryejnë betimin pa funksionalizimin e asambleve komunale, para të cilave solemnisht marrin detyrën.

Kryeministri nuk qartësoi se si do të mundësohet zhvillimi i procesit të betimit.

Kurti, gjithashtu, bëri me dije se në komunën e Mitrovicës së Veriut, ku Erden Atiq nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje ka marrë mandatin e kryetarit, janë emëruar edhe katër drejtorë. "[Janë] një serb, një boshnjak, një egjiptian dhe një shqiptar, prej tyre dy gra dhe ky është progres që duhet të normalizohet", tha Kurti.

Zgjedhjet në katër komunat në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, u mbajtën pasi kryetarët paraprakë nga partia më e madhe e serbëve në Kosovë, Lista Serbe, dhanë dorëheqje nëntorin e kaluar.

## Hyn në fuqi metodologjia e taksave të kyçjes në rrjetin e shpërndarjes

PRISHTINË, 24 MAJ - Metodologjia e taksave të kyçjes në KEDS është aprovuar nga ZRRE-ja dhe ka hyrë në fuqi. Kjo metodologji, e para e këtij lloji, parasheh aplikimin e taksave të reja për kyçje dhe për shkyçje.

Qëllimi i metodologjisë së taksave për kyçje në rrjetin e shpërndarjes është t'i rregullojë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve.

Në metodologji parashihet që taksa e kyçjes për konsumatorët e rinj me kapacitet deri në 5 kWh të ulet nga 100 sa është aktualisht, në 60 euro. Ndërsa sa i përket taksës së kapacitetit, nëse një konsumator kërkon që të regjistrohet ose të shtojë kapacitetet, dhe nëse ka kapacitete të lira në vendin ku kërkohet, atëherë taksa është zero.



Në metodologji parashihet edhe aplikimi i taksës për shkyçje të konsumatorëve, që është paraparë të fillojë nga 17,70 euro (duke përfshirë TVSh-në) dhe vazhdon në bazë të kategorisë së konsumatorit dhe të konstantës. "Lusim konsumatorët tanë që brenda afatit ligjor, i cili shkruan në secilën faturë që konsumatori e pranon, ta kryejë pagesën, meqë shkyçja aplikohet si masë finale e mospagesës së obligimeve ndaj kompanisë. Kryerja në afatet ligjore e obligimeve kontraktuale në mes të kompanisë dhe konsumatorit nënkupton edhe fuqizim të partneritetit në mes të dy palëve, çka është edhe qëllimi kryesor i metodologjisë së re", ka njoftuar KEDS-i.

# Kurti: Po ndërtojmë projektin e parë në Ballkan për ngrohje qendrore me energji diellore

PRISHTINË, 24 MAJ - "Kosova qëndron krahas shteteve partnere evropiane në përpilimin e zbatimin e strategjive dhe në zhvillimin e miratimin e politikave të cilat në thelb synojnë tranzicionin e drejtë drejt ekonomisë së gjelbër e të qëndrueshme", ka thënë kryeministri Albin Kurti në konferencën "Java e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë".




Teksa foli për fokusin e qeverisë gjatë mandatit të parë në adresimin e pabarazive sociale dhe ekonomike, veçoi se investimet që po bëjmë në energjinë e ripërtëritshme vijnë si rezultat i Strategjisë së Energjisë e cila jo vetëm që është strategjia e parë e vendit tonë e bazuar në studime e analiza të thella, mirëpo është edhe strategjia e parë e cila në thelb synon dekarbonizimin dhe tranzicionin e drejtë energjetik. "Përmes investimeve, Korporatën Energjetike të Kosovës po e kthejmë në ndërmarrjen më të pastër duke instaluar 100 megavat energji diellore. Po ndërtojmë rezervat akumuluese me kapacitet ndër më të mëdhenjtë në Evropë përmes grantit më të madh në histori të vendit tonë me 236.7 milionë dollarë nga MCC-ja, po ndërtojmë projektin e parë në Ballkan për ngrohje qendrore me energji diellore, me vlerë 80 milionë euro, po prezantojmë skema konkurruese duke filluar me ankandin e parë të energjisë diellore me kapacitet prej 100 megavatesh, të cilin e lansuam para dy jave", ka theksuar Kurti.

Përveç krijimit të vendeve të reja të punës, përmes politikave qeverisëse, kryeministri Kurti ka pohuar se do të dizajnohen edhe programe rikualifikimi për punëtorët që në të ardhmen ndërmarrjet publike dhe bizneset private të kalojnë sa më lehtë në ekonomi të gjelbër.

Në fjalën e tij, kryeministri listoi angazhimin e qeverisë, nismat dhe projektet që janë bërë dhe planifikohen të bëhen për të kontribuar në një mjedis të pastër por që, siç theksoi ai, një zhvillim i qëndrueshëm arrihet atëherë kur sigurohemi që përgatitemi e përshtatemi ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, andaj edhe lobimi ynë për drejtësi klimatike ndaj Kosovës nuk do të ndalet.

Në këtë konferencë bashkë me kryeministrin Kurti ishin edhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, zëvendësministra, ambasadorë të akredituar në Kosovë dhe përfaqësues të ndryshëm të institucioneve e organizatave.

## KESCO certifikohet me tri ISO standarde

Prishtinë, 24 maj - Certifikimi i KESCO-s me tri lloje të ISO-ve është një nga treguesit më të rëndësishëm sa i përket nivelit të profesionalizmit të kompanisë dhe avancimit të shërbimeve në raport me konsumatorët. Kategoritë ISO 9001:2015 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë, ISO 14001-2015 - Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit, si dhe ISO 45001-2018 - Sistemet e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë janë standarde të cilat bazohen në shërbimet tona kualitative, fokusin te konsumatorët, ruajtjen e ambientit, pa anashkaluar shëndetin dhe sigurinë e punonjësve tanë. "KESCO në vazhdimësi po ecën me trendët botërorë sa iu përket shërbimeve të cilat u ofrohen rreth 700 mijë konsumatorëve. Si rrjedhojë, për menaxhimin e cilësisë në punë jemi certifikuar prej punës së jashtëzakonshme të departamenteve përkatëse brenda kompanisë duke filluar nga sigurimi i energjisë elektrike për konsumatorët, kujdesi ndaj tyre dhe informimi i saktë. Për sistemin e menaxhimit të mjedisit, pos qasjes proaktive në avancimin e energjisë së gjelbër, KESCO përkujdeset edhe për ruajtjen e parametrave të tjerë mjedisorë. Tregues konkret është blerja dhe futja në përdorim së fundmi e 15 veturave elektrike të cilat janë shumë miqësore për mjedisin e duke bërë plane strategjike afatgjatë për ruajtjen e saj", ka njoftuar KESCO.

Drejtori i Furnizimit në KESCO, Huseyin Ozen, ka thënë se një certifikim i tillë është tejet domethënës për kompaninë.



# Rënia e Bakhmutit, dështimi më i madh i udhëheqësve kosovarë në skenën ndërkombëtare!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**Mundi i shkuar huq:** Informatat e fundit thonë se Bakhmuti, qytet i shndërruar në rrënoja gjatë luftës dyvjeçare midis Ukrainës dhe Rusisë, ka rënë në duar të grupit paramilitar mercenar "Wagner", gjithnjë sipas pohimeve të Jevgenij Primozhinit, udhëheqës i këtij formacioni paraushtarak mercenar. Në këtë luftë, çlirimtare për Ukrainën dhe okupuese për Rusinë, lufta e ftoftë në planin e propagandës ka qenë jashtëzakonisht e theksuar; palët ndërluftuese dhe përkrahësit e tyre asnjëherë nuk e kanë treguar të vërtetën. Unë sigurisht se do t'i merrja me rezervë deklaratat e Primozhinit, mirëpo edhe më shumë po më brengos heshtja e pakuptueshme e presidentes me korrespondencë të Kosovës e cila, në të njëjtën kohë, pjesën më të madhe të aktiviteteve ia ka kushtuar pikërisht luftës në Ukrainë, duke e përkrahur Zelenskin dhe duke e luftuar me të gjitha mjetet Putinin e Madh në Rusi dhe Putinin e Vogël në Serbi (Aleksandar Vuçiqin). Botërisht nga distanca jepte këshilla se si duhet të luftohet ushtarakisht dhe politikisht në Ukrainë gjithnjë e këshilluar nga Garda Pretoriane e identifikuar në linjat buxhetore si këshilltarë politikë të saj; të jashtmit për ta luftuar Rusinë dhe Serbinë, të brendshmit për t'i luftuar mediet dhe ata që nuk pajtohen me Zyrën e Kryeministrit e quajtur Presidenca e Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, si intelektual multidisiplinar dhe mesia i grixhës që për interesa personale dhe materiale i shkon pas, deri në theqafje të kryeministrit dhe jo të tyre, ka dokumentuar krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit që i ka bërë Rusia më mirë dhe më bindshëm se që do ta bënte Karim Khan, kryeprokurori ndërkombëtar për hetimin e krimeve ruse në Ukrainë. Përcjellësit e rregullt të kryeministrit, që edhe pordhët e tij i marrin si puhiza freskuese aromatike të një nate vere, me mallëngjim dhe pasion e kujtojnë përshkrimin brilant që e bëri kryeministri i Kosovës për ta përshkruar masakrën që e bëri Rusia në Buça të Ukrainës gjatë drejtimit të tij opinionit botëror, që me ankth dhe padurim priste një prononcim të tillë. Madje duke e shpërfillur enciklikën e Papës Françesku urbi et orbi në Sheshin e Shën Pjetrit në Vatikan!

Besnik Bislimi, njeri pa të kaluar politike dhe kombëtare, në përpjekje për ta ndërtuar të ardhmen përmes një të tashmeje mashtruese dhe nënshtruese, të gjitha angazhimet kryesore i ka të përqendruara në futjen e të gjitha sanksioneve ekonomike Rusisë dhe Bjellorusisë të cilat, nëse mblidhen, matematikisht janë më shumë se të gjitha sanksionet që ua ka vendosur Amerika, me të gjitha shtetet aleate, nuk arriti ta thyejë boshtin kurrizor të ekonomisë ruse dhe bjelloruse ndonëse, të jemi të drejtë dhe të sinqertë këto ekonomi i ka sjellë buzë bankrotimit në kohën kur ekonominë kosovare, bashkë me Teneqe Muratin, urrejtësin e madh të UÇK-së dhe komandantin e mercenarëve, tashmë e ka falimentuar!

Donika Katran (Shvarc) Gërrvalla, kjo sizifja që me një këmbëngulje mahnitëse, ndonëse pa asnjë sukses po përpiqet ta bindë qytetarinë kosovare se është ministre për Punë të Jashtme e Kosovës, kohën më të madhe e ka shpenzuar në luftë kundër Rusisë, në përkrahje të Ukrainës, kundër UÇK-së dhe kundër çlirimtarëve që e sollën lirinë, e shpallën pavarësinë dhe e ndërtuan shtetin e që tash po mbahen peng në Burgun e Hagës. Me një fjalë, dora e djathtë diplomatike dhe politike e Volodimir Zelenskit. Gjatë mandatit të saj deri më tani asnjë shtet nuk e ka njohur Kosovë, madje as Ukraina.

Mos ta injorojmë kontributin e madh të kryefolësit sheik të Kuvendit të Kosovës, Galuk el Thani, që i dha hapësirë të madhe një deputeti nga Ukraina, shtet që as nuk e njeh Kosovën e pavarur dhe as që e ka mendjen ta njohë këtë pavarësi, gjysmë të dhunuar nga ndërmjetësuesit dhe "lehtësuesit".

RTK-ja që më parë ishte shtëpia e vetme publike informative me letra, e shndërruar në bastion apo shtëpi publike informative të pushtetit aktual, dha një kontribut të jashtëzakonshëm për Ukrainën duke i punësuar gazetarët ukrainas të ikur nga Ukraina si lektorë të gjuhës shqipe (për këtë arsye në aspektin gjuhësor në RTK ka shumë përmirësime) dhe, në të njëjtën kohë, përzuri një Bord të mëparshëm që në aspektin e integritetit profesional, krahasuar me bordin aktual, është Akademi Mediale.

Trafiku Urban gjithashtu kontribuoi për Ukrainën në luftë kundër Rusisë duke i pajisur gazetarët ukrainas me bileta falas për linjat e trafikut urban në kohën kur ndonjë hallexhi që nuk ka pasur mundësi ta paguajë biletën e dërgojnë drejt dhe krejt në Qendrën e Ndalimit Policor!

Dhe, do të ishim të padrejtë me komunën e Prishtinës nëse ia mohojmë kontributin për Ukrainën dhe kundër Rusisë. Në një faqe ballore anësore të Hotelit Grand në Prishtinë e keni një hapësirë të madhe ku shkruan FREE UKRAINE në kohën kur as Grandi e as Kosova nuk janë krejtësisht të lira; Hotel Grandi ka kontest për të drejtën e pronësisë, Kosova po kontestohet si shtet nga Serbia sepse këtë pavarësi nuk po e noterizojnë noterët nga Nishi dhe Kragujevci, Mirosllav Lajçak dhe Joseph Borrell.

Jam shumë i zhgënjyer që pas të gjitha këtyre angazhimeve të udhëheqësve më të lartë të Kosovës gjendja në terren nuk është në përputhje me angazhimin e tyre, me sakrificën e tyre, me injorancën e tyre dhe me mediokritetin antologjik!

Siç thuhet se "shpresa vdesë e fundit" e që është ngushëllim për oportunistët, edhe unë po besoj se shpresa është ende gjallë. Në kundërofensivën e paralajmëruar të Ukrainës, pa asnjë dyshim se mund të kemi zhvillime të jashtëzakonshme apo përmbushje të planeve gjeniale të udhëheqësve të lartë kosovarë, shkatërrimin e makinerisë okupuese ushtarake dhe teknike ruse dhe përballje të dy titanëve apo udhëheqësve të mercenarëve, Wagnerit rus dhe Teneqes multietnik kosovar!

**Betimi në Kullën e Isa Boletinit:** Pas "çlirimit" të Veriut të Kosovës nga bandat paramilitare të Serbisë, pasi e përzëmë Wagnerin nga kjo pjesë, dikur të okupuar të Kosovës, pasi e vendosëm flamurin në stilin e Mitrush Kutelit në novelën "Tregtar flamujsh" (i hoqëm të Serbisë), nuk na mbeti asgjë tjetër vetëm që kryetari që fitoi numrin maksimal të votave ta jep betimin gjë që edhe e bëri. Atiqi, kryetar në Mitrovicë, Antiqi, kryetar në Surdullicë! Ka mbetur që të hapet edhe ura mbi lumin Ibër për të cilën fituesit e zgjedhjeve kanë marrë vendim që të bëhet. Janë edhe dy pengesa të vogla, njëra e natyrës teknike, tjetra e natyrës fiziologjike; të studiohet fizibiliteti teknik i urës dhe fizibiliteti i prapanicave të këtyre që duhet ta hapin urën. Rezultatin e kemi të qartë, besoj shumë!

Para një kohe pata shkruar se betimi i disa kryetarëve në veri mund të bëhet edhe në lokacione jashtë objekteve komunale. Në këtë pikë jemi pajtuar 100 % me ambasadorin Hovenier. Tash, nëse është i vërtetë lajmi njëri ndër kryetarët paska vendosur ta japë betimin në Kullën e Isa Boletinit. Folklor politik dhe patriotik! Më së miri do të ishte që të vesh tirqit e Isës, të vendosë jataganët dhe armët e tjera të Isës në shokë sikur që bëri Isa në Londër dhe të betohet me betimin se: "kur është Kosova (jo Shqipëria) mirë, edhe unë jam mirë ...". Krejt kësaj ikonografie që i përmbush të gjitha kushtet e fizibilitetit teknik i mungon një kusht i fizibilitetit anatomik; i mungojnë koçet e Isa Boletinit!

# Ish-të mbijetuarit e masakrës në Burgun e Dubravës vizitojnë familjet e ish-krerëve të UÇK-së që po mbahen në Hagë



Një grup i të mbijetuarve të masakrës së ndodhur në burgun e Dubravës më 19-24 maj 1999 këto ditë e ka vizituar familjen e ish-presidentit Hashim Thaçi. Ata janë pritur ngrohtësisht nga baba i tij, Haxhi Thaçi. Të mbijetuarit e masakrës në Burgun e Dubravës, Bajrush Xhemajli, Nait Hasani, Hajredin Hyseni, Isak Shabani, Xhelal Canziba, Bislim Zogaj, Ismet Mahmuti, Blerim Camaj, Defrim Rifaj, Musë Gashi dhe Sadik Zeqiri, e kanë njoftuar bacën Haxhi për vizitën përkujtuese të bërë në përvjetorin e 24-t të masakrës në Dubravë, në të cilën forcat serbe patën vrarë dhe masakruar mbi 117 të burgosur shqiptarë dhe plagosur mbi 300 tjerë, me të vetmin qëllim që nuk i përkisnin etnisë serbe.

Baca Haxhi shprehu dhimbje për ngjarjet tmerruese të 24 vjetëve më parë në Burgun e Dubravës dhe u shprehu ngushëllime familjeve të të rënëve. Gjatë qëndrimit të ish-të burgosurve në kullën e Haxhi Thaçit, ish-të mbijetuarit e masakrës u njoftuan për vizitat dhe bisedat që i bëjnë me ish-presidentin Thaçi familjarët e tij. "Kam qenë një herë në vizitë me gruan time. Aty i kam pa të gjithë. Që të gjithë po mbaheshin ashtu siç u ka hije, por diçka më ka mundu shumë, kur më kontrolluan në hyrje, më thanë ta heqë edhe plisin e bardhë. Këtë nuk mujta me e duru dhe u bërtita gardianëve në gjuhën time", tregoi plaku nga Buroja, Haxhi Thaçi, i cili shtoi se "nuk po më dhimbet vetëm djali im, por të gjithë që janë aty, sepse janë të pafajshëm, ashtu siç keni qenë edhe ju të pafajshëm në burgjet e Serbisë".

Në emër të të ish-të burgosurve, Bajrush Xhemajli e falënderoi për mikpritjen dhe uroi që sa më parë të kthehen në Kosovë çlirimtarët e saj të cilët po mbahen padrejtësisht në Hagë.

## Të mbijetuarit e masakrës në burgun e Dubravës vizitojnë familjen e Kadri Veselit

Të mbijetuarit e masakrës së ndodhur më 19-24 maj 1999 e kanë vizituar edhe familjen e ish-kryeparlamentarit Kadri Veseli. Ata janë pritur nga bashkëshortja e tij, Violeta dhe fëmijët e saj. Të mbijetuarit e masakrës në Burgun e Dubravës, Bajrush Xhemajli, Nait Hasani, Hajredin Hyseni, Isak Shabani, Bislim Zogaj, Defrim Rifaj e Sadik Zeqiri, e njoftuan zonjën Veseli për vizitën përkujtuese të bërë në përvjetorin e 24-t të masakrës në Dubravë. Ish-të burgosurit bashkëbiseduan me fëmijët e Kadri Veselit për aktivitetin e prindit të tyre dhe për rolin e tij gjatë luftës çlirimtare të Kosovës. Nait Hasani ua bëri me dije fëmijëve të Veselit se edhe grupi i cili ishte në takim ka qenë nëpër burgjet e Serbisë dhe edhe disa nga ta kishin lënë fëmijët e tyre në shtëpi, por pas një kohe tani janë bashkuar dhe ua bëri me dije se do të vijë shumë shpejt dita që edhe Kadriu do t'i bashkohet familjes për ta vazhduar jetën aty ku e ka









lënë, sepse Kadriu me shokë po mbahen padrejtësisht në Hagë, dhe drejtësia do ta mund padrejtësinë dhe çlirimtarët do të shpallen të pafajshëm.

Zonja Violetë i falënderoi shokët e Kadriut për vizitën e tyre bërë në Prishtinë, por edhe për vizitën që ia kanë bërë në Hagë.

### Të mbijetuarit vizitojnë edhe familjen e Rexhep Selimit

Të mbijetuarit e masakrës së Dubravës, në vazhdën e vizitave te familjarët e Thaçit, Krasniqit, Veselit e Selimit të cilët po mbahen në burgun e Hagës, kanë vizituar edhe familjen e Rexhep Selimit. Ata janë pritur nga bashkëshortja e Rexhës, deputetja Shqipe Selimi.

Edhe bashkëshorten e Selimit ky grup i të mbijetuarve e njoftoi për situatën e para 24 vjetëve, ku pjesë e të mbijetuarve ishte edhe vëllai i Rexhepit, Asllani, i cili këto ditë botoi librin "Tmerri ka emër". Naiti dhe të tjerët evokuan kujtime të hershme rreth aktiviteteve me Rexhën dhe me të tjerët, të cilët kishin filluar qysh herët të punojnë për çlirimin e Kosovës.

Shqipja i falënderoi për vizitën dhe u shprehu mirënjohje për solidarizimin e bashkëveprimtarëve të hershëm të Rexhës me të paraburgosurit që po mbahen në Hagë.

### Vizitë edhe në familjen e Jakup Krasniqit

Të mbijetuarit e masakrës së Dubravës takuan edhe zonjën Sevdije Krasniqi, bashkëshorten e Jakup Krasniqit, znj. Sevdije, të cilën e njoftuan për atë që kishte ndodhur 24 vjet më parë në Burgun e Dubravës, gjithashtu folën edhe për sakrificën e Jakup Krasniqit i cili kishte mbajtur mbi 10 vjet burg për çështjen kombëtare.

Znj. Sevdije i falënderoi ish-të burgosurit politikë për këtë vizitë dhe i falënderoi që po solidarizohen dhe po kujdesen që përmes këtyre vizitave t'ua lehtësojnë sadopak dhimbjen dhe mërzinë familjarëve të tyre që po mbahen padrejtësisht në qendrën e paraburgimit në Hagë.

Pas çdo vizite dhe takimi me familjarët e Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit e Rexhep Selimit, kërkesa e tyre ishte që shqiptarët duhet të jenë njëzëri në mbështetje të luftës së pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe t'i bëhet me dije kujtdo se lufta e UÇK-së ka qenë çlirimtare.

Në ditët e ardhshme ish-të mbijetuarit e masakrës dhe bashkëveprimtarët do t'i vazhdojnë vizitat edhe nëpër familjet e çlirimtarëve të tjerë që po mbahen në paraburgim në Hagë.

(Epoka e re / Sadik ZEQIRI)



# Bylbyl Duraku, studenti që u mbijetoi torturave çnjerëzore serbe dhe masakrës së Dubravës

*- Regjimin serb e krahasoj me atë nacist të Hitlerit*



Nga Qemajl KRASNIQI

Bylbyl Duraku nga Krusha e Madhe ka vuajtur nëpër burgjet serbe dy vjet e gjashtë muaj dhe gjatë asaj kohe ka përjetuar tortura e abuzime nga më të tmerrshmet. Ai rrëfen në vetën e parë për përjetimet e tij, mirëpo rrëfimi i tij nuk është vetëm personal, sepse metodat e aplikuara, mjetet e përdorura dhe qasja e serbëve ndaj shqiptarëve është e njëjta për më shumë se një shekull - torturë, vrasje, mizori, dhunë çnjerëzore, keqtrajtim psikik e fizik, me tendencë asgjësimin e një populli autokton. Bylbyli u mbijetoi torturave fashisoide serbe dhe i mbijetoi edhe masakrës në Dubravë. Vendin ku është mbajtur ai dhe shqiptarët e tjerë ai nuk e quan burg, por një lloj kampi përqendrimi nacist ku bëhen eksperimente me trupat e shqiptarëve dhe ku është ushtruar dhunë e shfrenuar sistematike.

- Pasojat i kemi vuajtur vazhdimisht për shkak të qëndrimit tonë si familje kundër regjimeve antishqiptare. Babai, Abdurrahmani, të cilin e kanë njohur të gjithë si baca Mon, si i ri kishte dalë në mërgim e pjesën më të madhe të jetës e kishte kaluar në Gjermani. Babai ynë ishte antikomunist i përbetuar, ndoshta edhe pse babai i tij Halili kishte qenë në shënjestër të regjimit komunist jugosllav duke u dënuar me 1 vit e gjysmë burgim dhe duke ia konfiskuar mbi 16 hektarë truall e tokë në vitin 1950. Me siguri kjo ka qenë një ndër arsyet, dhe jo e vetmja, që babai Mon vazhdimisht na ka porositur të kemi kujdes me kë shoqërohemi, sepse pushteti komunist mund të bënte kurthe të ndryshme. Nëna ime Mihanja, vajza e parë e shkolluar nga treva e Llapit, vajza e Metë Podjevës (patriot dhe njeri i dalluar në atë anë), e kishte të kryer Normalen e Prishtinës, e nis rrëfimin e tij Bylbyl Duraku, ish-kryetar i Unionit të Studentëve në Shkollën e Lartë Pedagogjike “Xhevdet Doda” në Prizren.

Në vitin 1998 studioja në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze në Prizren. Protestat e 1 tetorit 1997 i dhanë dimension të ri rezistencës në Kosovë. Kemi organizuar protesta dhe aksione të ndryshme kundër pushtimit serb. Nuk e bëja këta vetëm pse isha shqiptar, por doja të luftoja për dinjitetin dhe lirinë time. Ndërkohë patëm rënë në kontakt me persona të UÇK-së dhe nisëm të interesohemi për ta organizuar rezistencën kundër pushtuesit serb. Një mik yni, Refik Çollaku nga Bregdrini, na e kishte siguruar armatimin dhe municionin me mjete vetjake. Planifikonim të kryenim aksione të armatosura kundër regjimit serb. Na arrestuan më 23 maj 1998. Në grup kishim tri vajza dhe gjashtë djem: Haqif Ilazi, Sherif Ilazi, Sejdi Bellanica, Dëfrim Rifaj, Leonora Morina-Duraku (tani bashkëshortja ime), Jehona Krasniqi, Behare Tafallari dhe Njazi Kryeziu. Na akuzuan për terrorizëm dhe bashkim kundër shtetit, sipas nenit 136 lidhur me nenin 125, alineja 1 e 2, bashkim për veprimtari armiqësore kundër shtetit dhe terrorizëm.

### Tortura ishte mjeti i vetëm i komunikimit të hetuesve serbë

Gjatë hetimeve në Prizren na kanë rrahur në mënyrë barbare tri ditë e tri net pa pushim. Torturat intensive na kishin dërrmuar dhe mezi mbijetuam. Nuk kanë pushuar as ditën, as natën torturat. Na mbanin lidhur me pranga tërë kohës duke na poshtëruar e goditur me gjithfarë mjetesh. Torturat kanë qenë të tmerrshme. Aq rëndë na kanë torturuar saqë nuk kam mundur të qëndroj në këmbët e mia, por është dashur që dikush të më mbajë për krahësh ose të më tërheqë zvarrë. Shokët më kanë thënë se i kanë futur edhe në korrent në elektroshok. Mua jo. Pas përfundimit të hetimeve nuk na kanë rrahur aq shumë, por dhuna dhe presioni psikologjik kanë vazhduar sistematikisht.

Më 24 gusht 1998 më dënuan me pesë vjet e gjysmë burg. Nga data 12 korrik 1998 derisa më transferuan në Nish kam dëgjuar britma të tmerrshme të njerëzve që torturoheshin vazhdimisht. Torturat zgjatnin gjatë gjithë kohës, ndërrim pas ndërrimi dhe asnjëherë nuk pranin. Britmat dhe ofshamat e njerëzve dëgjoheshin thekshëm. Nuk kishte asnjë moment qetësie dhe për ne kjo ishte torturë shtesë, ngaqë e kishim kaluar atë ferr para atyre njerëzve fatkeq. Nuk mund të rrëfehet gjithë ai tmerr. Nuk di ta kemi pasur një moment qetësie gjatë asaj kohe. Gjatë qëndrimit në burgun e Prizrenit, edhe kur na vinin për vizitë prindërit, torturat nuk pushonin. Prindërit tanë dëgjonin britmat e atyre të burgosurve shqiptarë që torturoheshin mizorisht. Prindërit i dëgjonin britmat dhe sikur nuk donin ta besonin se njerëzve po u ndodhte një gjë e tillë. Edhe pse populli ynë i kishte të njohura metodat barbare serbe mbi shqiptarët, ne duhet të thoshim se nuk po na rrihnin, ndërsa britmat e njerëzve që torturoheshin dëgjoheshin qartë dhe zëshëm. Gardianët na qëndronin mbi kokë gjatë kohës sa zgjaste vizita dhe

nëse dikush guxonte të fliste "më shumë nga sa duhej", e pësonte keq. Nuk dëshiroja që prindërit e mi t'i dëgjonin britmat e njerëzve, por nuk bëja dot asgjë që të mos dëgjoheshin rënkimet e njerëzve të pafuqishëm. Madje nganjëherë dëshiroja që ata të mos vinin fare në vizitë vetëm për këtë shkak.

### Transferimi në Nish dhe "tuneli" i tmerrit

Në burgun e Prizrenit na mbajtën deri më 11 shtator 1998, pastaj na transferuan në Nish. Atje na mbajtën deri më 29 prill 1999. Në Nish na kanë zhveshur vetëm në brekë dhe na kanë rrahur me gjithfarë mjetesh që kishin. Çfarë epshe shtazarake që kishin dhe sa të motivuar ishin të torturonin njerëz të lidhur dhe të pafuqishëm. Gardianët e kishin formuar të ashtuquajturin "tunel", përmes të cilit ne duhet të kalonim. Dikush arrinte të dilte me më pak dajak, por shumica rrëzoheshin dhe vaj halli për ata që binin në tokë. Njerëzit ishin të gjakosur dhe të mavijosur në krejt trupin. Edhe nëpër qeli na kishin futur me ndonjë serb ordiner dhe torturat vazhdonin edhe aty. Dikush kishte fat dhe rastiste në ndonjë të burgosur serb më të përmbajtur dhe që nuk i torturonte shqiptarët. Mua më qëlloi një serb që kishte qenë paramilitar në Bosnje dhe ishte tepër agresiv. Vazhdimisht më provokonte me fjalë fyese, por ndoshta për fat që isha trupmadh hezitonte të më vërsulej drejtpërdrejt. Vetëm njëri ndërrim ishte më i qetë. Na rrihnin edhe gjatë kohës kur hanim bukë. Në fytyrat e të burgosurve shiheshin hematoma, gjakosje dhe ënjtje të fytyrës. Këto pamje ishin të zakonshme dhe dikur nuk na bënin më përshtypje.

Më kujtohet një moment me datë 31 mars 1999 kur na zhvendosën nga një qeli në tjetrën, që quhej izolim. Më futën përmes "tunelit". Në duar mbaja një pako me disa gjëra personale. Më nxorën nga qelia dhe gjatë gjithë kohës më godisnin deri sa rashë zvarrë. Mezi shpëtova. Më futën në një qeli ku kishte shumë persona dhe aty nuk kishim ku të shtriheshim. Na nxirrnin nga qelitë tona dhe na rrihnin pa mëshirë. Na futnin në pjesën ku ishte izolimi dhe duart duhej t'i mbanim pas shpine e të mos e ngrehnim kokën. Nëse konsideronin se nuk na kishin shkaktuar dhimbje mjaftueshëm na zhvishnin dhe na rrihnin deri në alivanosje. Më kujtohet se pas këtyre përjetimeve arrita të kthehem zvarrë në qeli dhe e futa kokën në filxhanin e tualetit që të freskohem. E lëshova pak ujin që të rridhte paksa. Vetëm ashtu më dukej se po merrja frymë, sepse mezi e hapja gojën.

Kam mundur të mbaj mend disa emra të atyre që na torturonin më së shumti, ndonëse edhe të tjerët nuk mbeteshin pas për nga ashpërsia e egërsia dhe dukej se bënin garë kush do të torturojë më shumë dhe me metoda më kreative. Shquheshin për sjellje brutale sidomos disa; njëri quhej Vojkan, një tjetër Pavlloviq, tjetri Spasiq, njëfarë Petriqi, kurse njëfarë Bixha, që ishte një lloj eprori, ishte ekzemplar për sjellje të ashpër dhe shumë armiqësore ndaj të burgosurve shqiptarë. Po ashtu ishte njëfarë Zhiviqi, pastaj njërin që e quanin Kuki, tjetrin Neniç, dhe secili ishte më i keq se tjetri. Më ngjanin me rojet gjermane në kampet naciste. Na torturonin rëndë dhe shpesh pa asnjë shkak.

### Në Dubravë vdekja ishte kudo

Më 29 prill 1999 nga burgu i Nishit na mblodhën dhe na ngarkuan nëpër autobusë. Na lidhën njërën dorë me njëri-tjetrin dhe na vendosën në rresht. Fillimisht na dërguan në burgun e Lipjanit, por ne nuk e dinim se e kishin në plan të na dërgonin në Dubravë. Pasi që ishte bombarduar nga NATO ura e Llazicës, autobusët bënë një kthim prapa dhe na dërguan në Lipjan. Gjatë gjithë kohës ishim të lidhur me pranga dhe askush nuk guxonte të ngrinte kokën për të parë anash apo përpara. Duart na ishin mpirë dhe disave u rridhte gjaku, pasi që na i kishin shtrënguar shumë prangat. Gardianët na ruanin me rreptësinë më të madhe dhe kush guxonte të bënte lëvizjen më të vogël pasonte ndëshkimi fizik brutal. Paramendojeni sa gjatë na është dashur të rrimë pa lëvizur dhe pa pasur asnjë mundësi madje as për të kryer nevojat personale. E kemi dëgjuar një shpërthim të fuqishëm dhe për një moment gardianët dolën nga autobusi dhe na lanë vetëm. E kuptuam se NATO i kishte bombarduar serbët. Aty ku ishim ne dhe një tjetër autobus me të burgosur shqiptarë na kthyen dhe na dërguan në Lipjan.

Të nesërmen, me 30 prill 1999, në hyrje të burgut të Dubravës ishin rreshtuar shumë roje dhe paramilitarë, të cilët e nxirrnin ndonjërin prej nesh dhe e grushtonin, e shtrinin përtokë duke e goditur me shqelma në mënyrën më brutale të mundshme. Deri më 17 maj i grumbulluan shumë të burgosur shqiptarë në Dubravë, duke i sjellë nga burgjet e Serbisë.

Më 19 e 21 maj kanë rënë bombat e NATO-s, me ç'rast u vranë disa të burgosur shqiptarë dhe u plagosën disa të tjerë. Me ato pak mundësi që kishim u ofronim ndihmë të plagosurve. Rojet e burgut u larguan nga ndërtesa dhe u vendosën në afërsi, duke vëzhguar lëvizjet tona. Në njëfarë mënyre ne e morëm nën kontroll burgun. Ushqeheshim vetë dhe nuk shihnim roje gjëkundi. Njerëzit flitnin shumë rrallë dhe vetëm ndonjëri aty-këtu merrte mundimin të tregonte apo hapte ndonjë temë. Nuk kishim asnjë mundësi ta bënim ndonjë plan. Vetëm pritnim se ç'do të ndodhte me ne.

Më 22 maj, në mëngjes herët, përmes altoparlantit, na ftuan që të dalim jashtë dhe të marrim sendet personale. Na thanë se do t'na dërgonin në një vend tjetër. Menduam se ashtu do të jetë me të vërtetë. Grupi ynë



qëndronim të bashkuar; Sherif Ilazi, Dëfrim Rifaj, Sejdi Bellanica, Haqif Ilazi, Nijazi Kryeziu dhe unë. Me ne qëndronte edhe Xhevat Daci, shqiptar nga Mali i Zi. Dolëm jashtë dhe u rreshtuam disi, jo në formë të rregullt. Ndërkohë Shefir Ilazi më tha se kishte një parandjenjë të keqe dhe se na kishin rreshtuar për t'na vrarë. E pashë për një fraksion të sekondës kur një gardian serb u ngrit nga kulla e vrojtimit me një granatahedhës krahu që e drejtoi kah ne. E kuptova se Sherifi pati të drejtë. Turma u shpërnda në panik. Granata eksplodoi në mesin e të burgosurve dhe gjymtyrët e njerëzve u hodhën gjithandej. Më pas pasuan të shtëna të pandërprera me pushkë automatike, mitralozë dhe armë të tjera. Shihja teksa para këmbëve të mia binin trupat e shokëve nga breshëria e të shtënave të serbëve. Plumbat binin mbi kokat tona si kokrrat e breshrit. Njerëzit binin si kallinj gruri kur kositen - të vdekur apo të plagosur. Sekush synonte të gjente një vend për ta futur kokën, por as nuk kishte një vend të tillë. Morëm arratinë dhe nuk e di as vetë si kam mundur të tërhiqem nga ajo plojë. Madje në duar kisha dy qese të mëdha me rrobat e mia dhe nuk më shkonte ndërmend as t'i hidhja e t'ia mbathja sa më shpejtë. Vetëm kur jam rrëzuar duke vrapuar kam vërejtur se kisha me vete ngarkesë, i kam lëshuar qeset dhe kam vrapuar deri te një hendek, ku kam qëndruar për disa sekonda.
Trupat e pajetë të të burgosurve dergjeshin nëpër oborr të burgut, ndërsa të plagosurit që rënkonin goditeshin me të shtëna të rralla. Sapo dëgjonim të shtënat tek e tek, e dinim se edhe dikush prej nesh u shua. Kishim frikë se NATO do të bombardojë përsëri, prandaj bashkë me Sherif Ilazin së pari me drita të thyera të neonit e mandej kemi marrë disa batanije dhe e kemi shkruar në oborr të burgut me batanije HELP, duke besuar se pilotët do ta vërejnë dhe nuk do të hedhin bomba mbi ne, por tashmë bombardimet ishin ndalur.

## Solidariteti i të burgosurve na jepte forcë

Moti ishte i mirë dhe kufomat nisën të dekompozohen shumë shpejt. Era e rëndë e mishit të kalbur të njerëzve përhapej gjithandej. Na i mbushte hundët dhe gojën. Më duket se edhe sot ajo erë e rëndë më kundërmon në hundë. Ishte e tmerrshme të mos kesh mundësi ta ndihmosh ndonjë shok të plagosur apo të tjerë që kishin frikë të madhe. Shumica kishin qëndrim stoik. Nuk kishim zgjidhje tjetër, pos ta inkurajonim njëri-tjetrin. Rezistenca jonë zgjati pak, sepse serbët kërkuan të mblidhemi në sallën e sportit dhe të mos mbanim në duar asgjë, ndryshe do të na vritnin. Duke kërkuar për të plagosur të tjerë i kam gjetur shtatë të vrarë në një kënd të bodrumit të shtëpisë së kulturës dhe një të plagosur të cilin e kemi nxjerrë jashtë, por fatkeqësisht edhe ai ka vdekur më vonë. Kufomat ishin gjithandej dhe kalonim skaj tyre e nuk na bënte përshtypje, sepse secili e ndjente se vdekja mund ta merrte në krahë në çdo moment. Habitesha me veten se si isha bërë i tillë, pothuajse pa ndjenja. Mua që më dhimbsej një pulë apo dele kur e prisnin, shihja njerëz pa këmbë, me kokë të çarë, krejt të gjakosur e totalisht të deformuar nga plagët që iu kishin shkaktuar vdekjen e krejt kjo nuk më bënte përshtypje!?
Rreth 150 persona i kanë vrarë ato dy ditë, ndërsa 193 kanë qenë të plagosur. Këtë shifër e di mirë ngase vetë jam përpjekur të ndihmoj të plagosurit, duke iu lidhur plagët dhe duke iu dhënë kurajë për të përballuar dhimbjet. Serbët gjurmuan gjithandej të burgosurit dhe pasi vranë e bënë kërdi sa deshën, ndaluan për një çast. Ne u detyruam të mbyllemi në pavijonin C ku vazhduam të mjekojmë shokët e plagosur. Mirëpo, duhet potencuar faktin se të burgosurit qëndronin të fortë e i jepnim zemër njëri-tjetrit dhe besonim se ishte afër fundi i luftës dhe se serbët nga dëshpërimi i humbjes po e kryenin një masakër të tillë. Kishte edhe raste kur të burgosurit nuk i bënin dot ballë presionit të madh psikologjik dhe tentonin të vetëvriteshin ose edhe u vetëvranë. Njerëzit erdhën buzë dëshpërimit dhe nuk besonin se mund të duronin e përjetonin tortura e tmerre të tjera, prandaj edhe i dhanë fund jetës. Të paktë ishin ata që i dhanë fund jetës në këtë mënyrë.
Dëshpërimi i madh dhe frika e vazhdueshme nga vdekja e torturat kanë shkaktuar trauma të pashërueshme tek të burgosurit shqiptarë. Njerëzit futeshin në hapësira shumë të ngushta vetëm për të gjetur një vend shpëtimi, por kishte raste kur gardianët, por edhe të burgosurit ordinerë serbë të armatosur, i gjenin dhe i ekzekutonin në ato strehimore të ngushta. Duke e parë një gjendje të tillë, kur fati ynë ishte në fije të perit mes jetës e vdekjes, u mobilizuam dhe provuam të bëjmë qëndresë. Të paktën të mos na vritnin pa asnjë rezistencë. Grupi ynë "Studentët e Prizrenit" (siç na quanin) rrëmbyem shufra hekuri dhe më vonë edhe disa të tjerë qëndruan në një krah të pavionit të gatshëm për t'u përballur me fatin. Pasi erdhën disa të burgosur nga kuzhina e burgut, ku po qëndronin pjesa më e madhe e të burgosurve, na e përcollën lajmin se gardianët kishin kërkuan që të dalim ose përndryshe do të na pushkatonin të gjithëve. Filluam t'i mblidhnim të plagosurit, duke i dërguar në sallë të sportit.

## Më dërguan në burgun e Beogradit në gjendje të rëndë fizike e shpirtërore

Më 11 tetor 2000 më transferuan nga Pozharevci në burgun qendror në Beograd. Më dërguan në repartin psikiatrik, gjoja se nuk jam mirë me shëndet mendor. Nuk pranova të qëndroj aty dhe kërkoja të kthehesha në burgun e Pozharevcit, prandaj edhe e kam thyer një derë. Mbaj mend se katër apo pesë gardianë më kanë rrëzuar për tokë dhe njëri prej tyre, përderisa isha me fytyrë për dyshemeje betoni, më ka goditur me shqelm në fytyrë dhe në atë moment i kam humbur ndjenjat. Vetëm kur jam përmendur e kam parë veten në spital, të lidhur për krevati me pranga. Vetëm njërën këmbë e kisha të lirë. Vinin gardianët dhe më rrihnin edhe të shtrirë në shtrat. Ngaqë nuk mund të bëja asgjë, e shaja me nënë një gardian që më godiste e më rrihte derisa alivanosesha.
Nuk mund ta hapja gojën, ngase ma kishin thyer nofullën. Aq isha i lodhur saqë as duart nuk mund t'i bashkoja. Ndërkohë më jepnin serum intravenoz. Më kanë thënë se në atë kohë kishin ardhur për vizitë prindërit katër herë, por në





gjendjen që isha e mbaj në mend vetëm vizitën e fundit. Isha lodhur shumë dhe mezi merrja frymë. M'i kishin marrë të gjitha rrobat e brendshme dhe isha vetëm me pizhame e këmbëzbathur. Nëse nuk gaboj, njëfarë Sebastian Griecourt nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar nga Franca, vinte e më vizitonte. Një herë i thashë se kam ftohtë. Ai i hoqi nga këmbët çorapët e tij e m'i dha. Në ato çaste edhe aq pak solidaritet më jepte zemër e shpresë.

## Ndonëse isha me familjarët e mi nuk e besoja se isha i lirë me të vërtetë

Nuk mbaj mend shumë nga ajo periudhë e qëndrimit në spitalin e burgut. Nuk e di sa kohë kisha qëndruar atje. Isha dobësuar jashtëzakonisht shumë dhe kur ma sollën një dokument për ta nënshkruar nuk kisha mundësi as ta mbaja lapsin në dorë. Më bëhej se më kërkonin të bëhesha bashkëpunëtor i serbëve, prandaj nuk desha ta nënshkruaj. Mirëpo, përfaqësuesi i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar më sqaroi se po lirohesha. Nuk mund ta besoja. Nuk shihja mirë. Më bëhej se isha verbuar. Vetëm kur me veturën e Kryqit të Kuq më dorëzuan te familjarët në Merdar, atëherë e besova se me të vërtetë isha përsëri i lirë. Kisha emocione të përziera.

Më dërguan në spitalin e Prishtinës dhe ma bënë një ekzaminim se mos isha sëmurë nga TBC-ja apo ndonjë sëmundje tjetër. Por nuk qëndrova aty, kërkova me ngulm të shkoja në shtëpi. Pas një muaj e gjysmë jam shtrirë në repartin Maksillofacial të QKUK-së. Më irritoi shumë fakti se një mjek më dërgoi në një sallë dhe aty ju jepte sqarime studentëve për gjendjen time shëndetësore, kurse një tjetër deshi të ma vendosë nofullën në vend duke mos ditur që kishte tre muaj që ma kishin thyer nofullën dhe duhej intervenim kirurgjik. Tragjikomike!

Dëshiroja që sa më parë të trajtohesha dhe të kthehesha në shtëpi. Nuk doja të qëndroja asnjë minutë larg shtëpisë dhe familjes sime. Më vonë më operuan dhe ma rregulluan nofullën, ndonëse ende nuk është në gjendjen më të mirë. Gjendja ime shëndetësore në atë kohë ishte e tmerrshme. Isha dobësuar shumë dhe mezi qëndroja në këmbë. Isha i zbehur i tëri dhe lëkura më ishte nxirë. Njerëzit vinin për vizitë, por shumicën nuk e njihja dhe nuk i dëgjoja mirë. Isha krejt i përhumbur. Nuk më besohej se isha në shtëpinë time. Nuk ka shkuar shumë kohë pas qëndrimit në spital, diku kah mesi i vitit 2001 kam gjetur punë dhe ndërkohë u jam kthyer studimeve që më kishin mbetur në gjysmë.

## Regjimit serb i kanë munguar vetëm dhomat e gazit sikur të Hitlerit

Mendoj se regjimi serb nuk dallon nga regjimi nacist i Hitlerit. Vetëm dallon koha dhe mjetet në dispozicion. Mbaj mend se gjatë transferimit nga Dubrava për në Lipjan, më 24 maj 1999, autobusi u prish dhe neve na futën në një kamion bagëtish. Mushamaja ishte hapur në një anë, ndërsa ne i shihnim fëmijët serbë në Lipjan që na bënin me dorë me gjeste sikur donin të na hiqnin kokën. Kjo dëshmon sa e thellë ishte urrejtja e tyre ndaj shqiptarëve. Mendoj se atij regjimi i kanë munguar vetëm dhomat e gazit.

Burgu të tjetërson dhe nuk mund të jesh vetvetja. Përvojat e rënda në burg dikë e kanë forcuar e dikë e kanë stërkequr. Nganjëherë bisedoj me disa shokë të vuajtjeve dhe qëndrimi ynë është se, kjo jetë për ne është si një shtesë apo "bonus". Kemi mundur të vdesim të gjithë. Personalisht ndiej se jam përpjekur të jap kontributin tim për vendin, por nuk kam bërë mjaftueshëm. Më e mira do të ishte sikur të mos kishim rënë në duart e serbëve dhe ta kishim vazhduar luftën me armë në dorë. Do të dëshiroja që të kisha dhënë kontribut më të madh për lirinë e Kosovës.

Mirëpo sapo u liruam nga burgu na u shkatërruan ëndrrat. Liria nuk ishte ajo që e kishim imagjinuar. Të burgosurit nuk janë trajtuar në mënyrën më të mirë. Me ta është dashur të merret më seriozisht sistemi shtetëror dhe t'u ofrohet një shans i dytë për jetë. Shoqëria nuk ka qenë e drejtë në raport me të burgosurit. Vetëm ata që kanë qenë në duart e serbëve mund ta dinë çfarë janë në gjendje të bëjnë ata mbi shqiptarët. Metodat e tyre barbare janë të denja për inkuizicionin mesjetar, por jo për një shtet që vetëquhet shtet e demokraci evropiane. Mungesa e hapësirës së nevojshme ma pamundëson të jap më shumë kontribut dhe kjo më shqetëson së tepërmi. Konkurrenca e ashpër dhe e pandershme më mundon, ngaqë do të doja të bëj më shumë. Konsideroj se kam mundësi intelektuale e profesionale të bëj shumë më shumë për Kosovën.

Më ngushëllon fakti se Serbia nuk është më e pranishme në Kosovë me polici e ushtri, por kjo nuk është e tëra që më bën më të lumtur. E di se është dashur të kemë rezistencë kundër pushtimit dhe ta bëjmë punën tonë, mirëpo disa sikur e shohin veten shpëtimtarë të këtij populli, prandaj mendojnë se i meritojnë edhe privilegjet e padrejta. Rrethanat ndërkombëtare kanë bërë që Kosova ta ketë rastin e vet për të dëshmuar aftësi shtetformuese. Pseudovlerat po dominojnë dhe ky është realitet i dhimbshëm. Mashtrimi, demagogjia dhe keqpërdorimet janë bërë pjesë përbërëse e jetës sonë dhe kjo më shqetëson më së tepërmi. Megjithatë, jam optimist. Vazhdoj të luftoj me mundësitë dhe potencialin tim intelektual dhe profesional dhe përpiqem ta jap kontributin tim aty ku punoj si mësimdhënës, në Shkollën Fillore "Abdyl Frashëri" në Prizren. Nuk pres lëmoshë e as keqardhje nga askush, thjesht dua ta ndiej veten se trajtohem në mënyrë të drejtë dhe të barabartë si qytetar i Republikës së Kosovës.




# Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Bashkëpunim i frytshëm në mes të KOK-ut dhe komunës së Prishtinës



PRISHTINË, 24 MAJ - Drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), presidenti Ismet Krasniqi dhe sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti, kanë pritur kryetarin e komunës së Prishtinës, Përparim Rama. Presidenti Krasniqi e falënderoi kryetarin Rama për bashkëpunimin e frytshëm për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si dhe mbështetjen që po e jep për sportin, ndërsa e njoftoi me projektet e ardhshme, sidomos ato ndërkombëtare. Kryetari Rama e përgëzoi presidentin Krasniqin për punën, sukseset dhe zyrat e reja, me ç'rast takoi edhe stafin e KOK-un. Palët kanë biseduar edhe për projekte të ndryshme të bashkëpunimit.

# Trepça synon barazimin, Besa titullin

Dy skuadrat me traditë të madhe në hendbollin e Kosovës, Trepça dhe Besa Famgas, do të përballen sonte (e enjte) në "Minatori" në ndeshjen e dytë finale. Vendasit synojnë ta barazojnë rezultatin e fitoreve në 1-1, ndërsa klubi nga Peja të shpallet kampion. Ndeshja do të fillojë në orën 20:15




EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 MAJ - Ndeshja e dytë e serisë finale të plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll zhvillohet sonte (e enjte) në mes të Trepçës dhe Besa Famgas. Ndeshjen e parë e ka fituar skuadra pejane. Klubi mitrovicas është i vendosur ta shfrytëzojë terrenin vendas në "Minatori" dhe me përkrahjen e shikuesve ta barazojë serinë finale në 1-1.

Kapiteni i Trepçës, Sali Maxhera, ka thënë se janë optimist për ndeshjen e dytë dhe me ndihmën e tifozëve të zjarrtë "Torcida" të arrijnë fitore. "Trepça në ndeshjen e së enjtes paraqitet e motivuar për rezultat pozitiv. Luajmë në terrenin tonë. Tashmë është dëshmuar shumë herë që Trepça ka numrin më të madh të tifozëve në Kosovë. Një tifozëri e zjarrtë si 'Torcida' është motivi ynë më i madh. Jemi të kompletuar dhe të fokusuar 100 për qind në ndeshjen e së enjtes. Motivimi ka qenë që prej fillimit të kampionatit. Një qëllim është arritur me sigurimin e Kupës së Kosovës. Ai trofe na ka shtuar motivin edhe për kupën tjetër, atë të kampionit", ka thënë Maxhera.

Te Besa kanë shprehur optimizëm se do ta vazhdojnë dominimin në elitën e hendbollit të Kosovës. Egzon Gjuka, kapiten i skuadrës pejane, ka thënë se Besa në secilën ndeshje ka udhëtuar për fitore dhe kjo nuk do të ndryshojë as të enjten kur shkon në Mitrovicë për ndeshjen e dytë finale. "Besa Famgas në çdo ndeshje ka udhëtar vetëm për fitore. Kur ta shtojmë faktin se nga udhëtimi në Mitrovicë mund të kthehemi si kampionë, atëherë vullneti dhe dëshira për këtë ndeshje është edhe më i madh. Trepça këtë vit ka qenë skuadër e organizuar mirë, aq sa e kam parë. Ndeshjet me Trepçën ishin të forta dhe besoj se dhe kjo do të jetë interesante. Por këtë edicion jemi 5-1 në favorin tonë dhe kjo dëshmon se jemi favoritë ndaj skuadrës mitrovicase", ka thënë Gjuka. "Ka shumë vjet që Besa e ka thënë fjalën kryesore në hendbollin e Kosovës. Peja ka qenë destinacioni i pothuajse të gjithë trofeve në të gjitha kategoritë në hendboll. Këtë vit kemi bërë një lëshim të madh në finalen e kupës, por kjo nuk zbeh dominimin e skuadrës së Besës në hendbollin e Kosovës. Në Pejë jemi të bindur që ky dominim do të vazhdojë edhe për shumë vjet të tjera", ka deklaruar Gjuka.

# Ballkani: Ndeshja ndaj Gjilanit zhvillohet në Suharekë




SUHAREKË, 24 MAJ (ER) - Ballkani ka arritur ta mbrojë titullin e kampionit në Superligën e Kosovës në futboll. Kampionët ndeshjen e fundit në kampionat janë mysafirë të Gjilanit, por me marrëveshje me klubin gjilanas dhe Federatën e Futbollit të Kosovës kjo ndeshje do të zhvillohet në Suharekë. "Festa e mbrojtjes së titullit kampion zhvendoset e tëra në qytetin e kampionëve. Duke gjetur gjuhë të përbashkët me skuadrën e Gjilanit dhe duke i falënderuar përzemërsisht për mundësinë e dhënë që të festojmë në qytetin tonë, gjithashtu dhe Federatën e Futbollit të Kosovës, ju bëjmë me dije se përballja e fundit kampionale do të luhet në stadiumin e qytetit në Suharekë. Falënderim i veçantë edhe për FFK-n. Mirupafshim të dielën në qytetin tonë në orën 15:00", thuhet në njoftimin e skuadrës së Ballkanit.

## Sot dhe nesër grumbullohet Kosova U18



Prishtinë, 24 maj - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll për U18 në konkurrencën e meshkujve do të grumbullohet sot (e enjte) dhe nesër (e premte). Grumbullimi do të mbahet në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve nga ora 10:30 deri në 13:00 për dy ditë radhazi. Në këtë grumbullim janë ftuar 44 lojtarë, ku përzgjedhësi i kësaj grupmoshe, Brahim Veseli, i cili do të asistohet nga ndihmësit Endrit Elashani dhe Safet Kastrat, do të kenë mundësi ta shohin formën dhe cilësinë e lojtarëve para grumbullimeve të ardhshme. "Dardanët" U18 janë në Grupin C së bashku me Estoninë, Rumaninë, Ukrainën, Holandën dhe Irlandën.

## Bostoni rihap garën për titullin në Lindje



Boston, 24 maj - Bostoni fitoi me rezultat 116-99 ndaj Miamit në finalen e katërt "play-off" në Konferencën e Lindjes, duke rihapur garën për titull. Tashmë Miami udhëheq 3-1 serinë dhe mbetet ende një fitore larg titullit në Lindje. Ndeshja e luajtur në fushën e Miamit u dominua nga miqtë, ndjeshëm më superiorë në fushë, duke e merituar fitoren. Tatum me 33 pikë e 11 rebounde ishte shënuesi më i mirë për Celticsin, ndërkohë që të gjithë titullarët e Bostonit realizuan mbi 10 pikë. Miami nuk arriti ta bëjë hapin vendimtar, duke zhgënjyer në këtë rast të parë. Butleri realizoi 29 pikë, por i pambështetur sa duhet nga skuadra e tij. Ndeshja e radhës do të luhet në fushën e Bostonit, që shpreson ende te mrekullia për të shkuar në finalet e NBA-s ku është kualifikuar Denveri.

# Ronaldo: Superliga e Arabisë Saudite do të jetë një nga pesë kampionatet më të mira në botë



Riyadh, 24 maj - Cristiano Ronaldo ka thënë se Superliga e Arabisë Saudite do të jetë një nga pesë kampionatet më të mira në botë pasi luajti në fitoren e fundit të Al-Nassrit të martën mbrëma. Ronaldo e ndihmoi Al-Nassrin për një fitore të jashtëzakonshme ndaj Al-Shababit falë një goli të bukur nga distanca, duke ia siguruar tri pikët. Fitorja i mban ata gjallë në garën për titull, pasi tani janë në vendin e dytë në kampionat, tri pikë prapa Al-Ittihadit, me dy ndeshje për të luajtur deri në fund. Pas një paraqitjeje frymëzuese, Ronaldo përshëndeti ligën vendase dhe sugjeroi që ajo do të bëhet një nga pesë kampionatet më të mira në botë në vitet e ardhshme nëse vazhdon të ecë në rrugën e zhvillimit. "Liga Saudite po bëhet më e mirë. Vitin e ardhshëm do të jemi edhe më mirë. Hap pas hapi mendoj se kjo ligë do të jetë një nga pesë ligat më të mira në botë", ka thënë fillimisht Ronaldo. "Por, atyre u duhet kohë, ata kanë nevojë për lojtarë dhe infrastrukturë. Besoj se ky vend ka potencial të jashtëzakonshëm, njerëz të mrekullueshëm dhe liga do të jetë e mrekullueshme", përfundoi ylli portugez. Ndryshe, Ronaldo ka arritur në kuotën e 14 golave nga 15 ndeshje të zhvilluara në Superligën e Arabisë teksa ka shtuar edhe dy asistime.

# Guardiola: Jam i impresionuar nga Interi, mund të na mposhtë




Manchester, 24 maj - Trajneri Pep Guardiola po e kërkon Ligën e Parë me Manchester Cityn dhe një tripletë brenda një sezoni. Interi është kundërshtari i tij në finalen e madhe të Stambollit, por trajneri spanjoll u trembet zikaltërve. "Fillova të shikoja disa minuta Interin, disa situata dhe jam shumë i impresionuar. Lojtarët më bënë përshtypje me lojën e tyre, me gjuhën e tyre trupore. Fillova t'i shikoja, thirra disa miq që jetojnë në Itali për t'i pyetur rreth mendimit të tyre për Interin. Të gjithë më thanë të qëndroj vigjilent se janë një ekip serioz dhe që godasin atëherë kur nuk e pret. Por gjithsesi këtë gjë e kuptova vetë duke parë ato pak minuta nga loja e tyre. Sigurisht që Interi mund të na mposhtë. Ata e kanë fituar këtë trofe tri herë dhe ne nuk kemi fituar asnjë, por ne do të bëjmë më të mirën tonë", ka thënë Guardiola. "Kam luajtur në Itali, e di mentalitetin që kanë ekipet italiane në fushë, në finale. Le të mos harrojmë se njëzet vjet më parë Seria A ishte liga më e mirë në botë dhe të gjithë lojtarët e trajnerët donin të punësoheshin atje. Interin e kam parë, është një ekip dinak, i cili duket sikur ia kupton lojën, taktikat, por atëherë kur nuk e pret, ndryshon totalisht dhe shënon, të vendosë në vështirësi", është shprehur Guardiola për "Gazzetta dello Sport".

## SHKURT

### Nadali largohet nga Wimbledoni

Rafael Nadali nuk ka dhënë një datë për një rikthim të mundshëm në fushë nga e cila është larguar që prej 18 janarit, pas humbjes në raundin e dytë të Australian Open, kur njoftoi tërheqjen nga Roland Garros. Pasi mungoi në Grand Slam, në të cilin ai ishte kampion 14 herë, spanjolli mbeti jashtë listës për Wimbledonin e radhës, garë të cilën e kishte fituar në vitet 2008 dhe 2010. Me konfirmimin e mungesës së Nadalit, aktualisht i 15-ti në renditjen ku ai ishte lider për 209 javë, dyert e Londrës u hapën për rusin Roman Safiullin. Sa i përket Nadalit, i cili ende ka një dëmtim të shkallës së dytë në këmbën e majtë, ideja për t'u rikthyer në fushë mbetet shumë e pasigurt pasi periudha prej gjashtë deri në tetë javë e planifikuar fillimisht për ta kapërcyer sëmundjen është bërë e pasigurt.

### Alba largohet nga Barcelona

Jordi Alba do të largohet nga Barcelona në fund të sezonit edhe pse e kishte edhe një vit kontratë. Zyrtarizimi pritet të arrijë shumë shpejt, por tashmë është i sigurt largimi i mbrojtësit të majtë nga gjiganti katalunas i cili do të heqë dorë nga një pjesë e pagës së vitit të fundit të kontratës. Së fundmi, Barça i dha fund bashkëpunimit me Sergio Busquetsin, i cili do të largohet po në fund të sezonit, ndërsa pak kohë më parë u largua edhe Gerard Pique. Alba do të largohet nga Camp Nou, por nuk do ta mbyllë edhe karrierën, pasi raportohet se ai do ta vazhdojë jashtë Spanjës.

### Bayerni e dëshiron Alvarezin

Bayern Munchen vijon kërkimet për ta gjetur pasuesin e Robert Lewandowskit. Që ka nga dita kur polaku u largua për te Barcelona, drejtuesit e klubit kanë studiuar tregun për të gjetur një sulmues të ri. Harry Kane, Osimhen e shumë të tjerë kanë qenë në tryezën e Oliver Kahn, por nga Argjentina vjen një emër surprizë.
Sipas së përditshmes "Ole", Bayerni ka vendosur nën shënjestër Julian Alvarezin te Manchester City. Sigurisht t'i rrëmbesh Pep Guardiolas një lojtar nuk është e lehtë, për më tepër që Alvarezi ka një kontratë deri më 2028. I vetmi detaj që mund ta afrojë me Bayernin është fakti që Alvarezi nuk është titullar në sytë e Guardiolas, status që nuk pritet të ndryshojë për sa kohë në skuadër është Erling Haaland. Alternativa B, në rast se dështon edhe kjo pistë, është Kolo Muani i Frankfurtit.

### Felixi dëshiron të qëndrojë te Chelsea

Joao Felix dëshiron të qëndrojë te Chelsea. Portugezi, i huazuar nga Atletico e Madridit që nga janari, nuk e fsheh dëshirën për të vazhduar në "Stamford Bridge" përtej kohëzgjatjes së huazimit të tij (përfundon më 30 qershor). "Do të doja shumë të vazhdoja këtu", ka deklaruar sërish nënshkrimi më i shtrenjtë në historinë e Atleticos së Madridit. Joao, gjithsesi, e pranoi se ende nuk e di se çfarë do të ndodhë me të sezonin e ardhshëm: "Ende nuk e di të ardhmen time, por këta katër apo pesë muaj më kanë gëzuar". Mbetet për t'u parë nëse londinezët do të pranojnë të paguajnë shumën 100 milionë euro që dëshiron Atletico. Nëse klubet e mëdha nuk do të jenë të gatshme ta paguajnë këtë shumë, nuk përjashtohet mundësia që portugezit t'i zgjatet huazimi edhe një vit tjetër në "Stamford Bridge".

## Mbappe nuk e ka ndërmend ta aktivizojë klauzolën e rinovimit

Vera duket se është e nxehtë në Paris. Kylian Mbappe është duke e rimenduar seriozisht të ardhmen e tij te Paris Saint-Germain. Në marrëveshjen e rinovimit që ai nënshkroi vetëm një vit më parë me klubin francez, përfshihej një klauzolë ku ai mund të rinovonte në mënyrë të njëanshme deri në qershor të vitit 2025. Kontrata që nënshkroi me PSG-në në fakt kishte një kohëzgjatje prej dy sezonesh fikse plus një vit opsion shtesë dhe jo tre si njoftuan fillimisht drejtuesit e klubit francez. Mbappe ka afat deri më 31 korrik 2023 për të bërë efektiv sezonin shtesë dhe të mbetet i lidhur me klubin e tij deri në vitin 2025 por, sipas gazetës franceze "L'Equipe", kjo nuk do të ndodhë. "Skenari është ndryshe", shkruan "L'Equipe", e cila thekson se në vjeshtë tashmë i kërkoi bordit të largohej për shkak të mosmarrëveshjeve, megjithëse tensioni mes dy palëve është qetësuar.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Pozita:** Statisticient/e i/e ri/e
**Departamenti:** i Statistikës
**Divizioni:** i Statistikave të Bilancit të Pagesa
**Grada:** 7
**Raporton tek:** Udhëheqësi/e i/e Divizionit të Statistikave të Bilancit të Pagesave

**Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësive:**

- Zbaton programin afatshkurtër të Divizionit të Statistikave të Bilancit të Pagesave në kuadër të Departamentit të Statistikës në pajtueshmëri me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të punës;
- Mbledhë, përpilon dhe validon statistikat e sektorit të jashtëm me qëllim të rritjes së cilësisë dhe përfshirjes të funksionit statistikor në BQK në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare;
- Përgatitë statistikat për publikimet periodike dhe jo periodike në pajtueshmëri me politikën e publikimeve dhe me përvojat më të mira lidhur me shpërndarjen e informatave statistikore;
- Jep mendime dhe rekomandime lidhur me çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me mbledhjen, përpilimin, validimin dhe publikimin e informatave statistikore;
- Propozon dhe merr pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin e procedurave të punës si dhe dokumenteve tjera administrative të Divizioni të Statistikave të Bilancit të Pagesave;
- Mbanë bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët lidhur me çështjet statistikore;
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

**Njohuritë e kërkuara:**

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, statistikës, matematikës, financës ose disiplina të ngjashme. Niveli pasuniversitar është i dëshirueshëm;
- Përvoja e punës në statistikë ose disiplina të ngjashme është e dëshirueshme;
- Njohuri e mirë në zbatimin e teknikave moderne statistikore;
- Të jetë i/e rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe/ose serbe;
- Gjuha angleze e preferuar;
- Njohje e mirë e programeve kompjuterike.
- Aftësi të mira për të punuar i pavarur, si dhe për të qenë konstruktivë në punë ekipore, kur afatet kohore janë të ngushta dhe oraret janë të paplanifikuara.
- Kandidati duhet të ketë vetiniciativë, aftësi të mira të komunikimit dhe koordinimit.

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **08 qershor 2023.**
- Aplikimi mund të bëhet online (https://hris.bqk-kos.org) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## KONKURS ZA RADNO MESTO

**Položaj:** Novi statističar
**Odeljenje:** Odeljenje za statistiku
**Odsek:** Odsek za statistiku i platni bilans
**Stepen:** 7
**Izveštava :** Direktoru Odseka za statistiku i platni bilans

**Opis dužnosti i odgovornosti:**

- Sprovodi kratkoročni program Odseka za statistiku i platni bilans u okviru Odeljenja za statistiku u skladu sa opisom dužnosti i odgovornosti rada;
- Prikuplja, sastavlja i potvrđuje statistiku spoljnog sektora u cilju povećanja kvaliteta i uključivanja statističke funkcije u CBK u skladu sa međunarodnim standardima;
- Priprema statistike za periodične i neperiodične publikacije u skladu sa politikom objavljivanja i najboljom praksom u vezi sa raspodelom statističkih informacija;
- Daje mišljenja i preporuke u vezi sa različitim pitanjima u vezi sa prikupljanjem, sastavljanjem, potvrđivanjem i objavljivanjem statističkih informacija;
- Predlaže i aktivno učestvuje u izradi radnih postupaka i drugih administrativnih dokumenata u Odseku za statistiku platni bilans;
- Održava potrebnu saradnju sa svim stranama u vezi sa statističkim pitanjima;
- Obavlja i druge poslove po zahtevu nadzornika.

**Potrebna znanja:**

- Univerzitetska diploma iz ekonomije, statistike, matematike, finansija ili sličnih disciplina. Postdiplomski nivo je poželjan;
- Poželjno je radno iskustvo u statistici ili sličnim disciplinama;
- Dobro poznavanje primene savremenih statističkih tehnika;
- Tečno da govori albanski i/ili srpski;
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika;
- Dobro poznavanje računarskih programa.
- Dobre sposobnosti za samostalan rad kao i da bude konstruktivan u timskom radu kada su rokovi kratki, a rasporedi neplanirani.
- Kandidat mora imati samoinicijativu, dobre sposobnosti u komunikaciji i koordinaciji.

**Svi kandidati moraju poslati sledeća dokumenta:**

- Zvanični obrazac CBK-a za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo gde je istaknuto interesovanje za ovaj položaj;
- Kopije diploma, a diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom boravku na Kosovu.

**Postupak prijavljivanja:**

- Rok za prijavu je **08 jun 2023. godine**.
- Prijavljivanje se može vršiti preko interneta (https://hris.bkk-kos.org) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik prijavljivanja neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko zvanične veb stranice: www.bkk-kos.org
- **Nekompletna dokumentacija neće se razmatrati. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Pozita:** Statisticient/e i/e Ri/e – Sektori i Statistikave të Llogarive Financiare
**Departamenti:** i Statistikës
**Grada:** 7
**Raporton tek:** Drejtori/e i/e Departamentit të Statistikës

**Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësive:**

- Zbaton programin e punës të Departamentit të Statistikës në pajtueshmëri me përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të Njësisë së Statistikave e Llogarive Financiare;
- Identifikon burimet kryesore të të dhënave për përpilimin e statistikave të llogarive financiare;
- Avancon kornizën raportuese për mbledhjen e të dhënave nga sektorët e nevojshëm institucional me qëllim të integrimit të tyre në statistikat e llogarive financiare.
- Mbledhë të dhënat statistikore dhe i kontrollon ato; integron statistikat nga sektori financiarë dhe jo-financiere dhe përpilon statistikat e llogarive financiare në nivel vendi në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare;
- Përgatitë statistikat për publikimet periodike dhe jo periodike në pajtueshmëri me politikën e publikimeve dhe me përvojat më të mira lidhur me shpërndarjen e informatave statistikore;
- Jep mendime dhe rekomandime lidhur me çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me mbledhjen, përpilimin, kontrollimin dhe publikimin e informatave statistikore;
- Propozon dhe merr pjesë në mënyrë aktive në hartimin e metodologjisë së përpilimit të statistikave, zhvillimin e procedurave të punës si dhe dokumenteve tjera administrative të Departamentit të Statistikës;
- Mbanë bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët për mbledhjen e informatave dhe çështjet tjera statistikore;
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

**Njohuritë e kërkuara:**

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, statistikës, matematikës, financës ose disiplina të ngjashme. Niveli pasuniversitar është i dëshirueshëm;
- Përvoja e punës në statistikë ose disiplina të ngjashme është e dëshirueshme;
- Njohuri e mirë në zbatimin e teknikave moderne statistikore;
- Të jetë i/e rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe/ose serbe;
- Gjuha angleze e preferuar;
- Njohje e mirë e programeve kompjuterike;
- Aftësi të mira për të punuar i pavarur, si dhe për të qenë konstruktivë në punë ekipore, kur afatet kohore janë të ngushta dhe oraret janë të paplanifikuara;
- Kandidati duhet të ketë vetiniciativë, aftësi të mira të komunikimit dhe koordinimit.

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **08 qershor 2023.**
- Aplikimi mund të bëhet online (https://hris.bqk-kos.org) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## KONKURS ZA RADNO MESTO

**Položaj:** Novi statističar - Sektor statistike finansijskih računa
**Odeljenje:** Odeljenje za statistiku
**Stepen:** 7
**Izveštava:** Direktoru Odeljenja za statistiku

**Opis dužnosti i odgovornosti:**

- Sprovodi program rada Odeljenja za statistiku u skladu sa opisom poslova i odgovornosti Jedinice za statistiku finansijskih računa;
- Identifikuje glavne izvore podataka za sastavljanje statistike finansijskih računa;
- Unapređuje okvir izveštavanja za prikupljanje podataka iz potrebnih institucionalnih sektora u cilju njihove integracije u statistiku finansijskih računa.
- Prikuplja statističke podatke i kontroliše ih; integriše statistiku iz finansijskog i nefinansijskog sektora i sastavlja statistiku finansijskog računa na nivou zemlje u skladu sa međunarodnim standardima;
- Priprema statistike za periodične i neperiodične publikacije u skladu sa politikom objavljivanja i najboljom praksom u vezi sa raspodelom statističkih informacija;
- Daje mišljenja i preporuke u vezi sa različitim pitanjima vezanim za prikupljanje, sastavljanje, kontrolu i objavljivanje statističkih informacija;
- Predlaže i aktivno učestvuje u izradi metodologije za izradu statistike, izradi radnih postupaka i drugih administrativnih dokumenata Odeljenja za statistiku;
- Održava potrebnu saradnju sa svim stranama za prikupljanje informacija i drugih statističkih pitanja;
- Obavlja i druge poslove po zahtevu nadzornika.

**Potrebna znanja:**

- Univerzitetska diploma iz ekonomije, statistike, matematike, finansija ili sličnih disciplina. Postdiplomski nivo je poželjan;
- Poželjno je radno iskustvo u statistici ili sličnim disciplinama;
- Dobro poznavanje primene savremenih statističkih tehnika;
- Tečno da govori albanski i/ili srpski;
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika;
- Dobro poznavanje računarskih programa.
- Dobre sposobnosti za samostalan rad kao i da bude konstruktivan u timskom radu kada su rokovi kratki, a rasporedi neplanirani.
- Kandidat mora imati samoinicijativu, dobre sposobnosti u komunikaciji i koordinaciji.

**Svi kandidati moraju poslati sledeća dokumenta:**

- Zvanični obrazac CBK-a za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo gde je istaknuto interesovanje za ovaj položaj;
- Kopije diploma, a diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom boravku na Kosovu.

**Postupak prijavljivanja:**

- Rok za prijavu je **08 jun 2023. godine**.
- Prijavljivanje se može vršiti preko interneta (https://hris.bkk-kos.org) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik prijavljivanja neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko zvanične veb stranice: www.bkk-kos.org
- **Nekompletna dokumentacija neće se razmatrati. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**

ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA

**ОДЕЉЕЊЕ ЗА ОБРАЗОВАЊЕ И КУЛТУРУ**

На основу Закона о Јавним службеницима Br.06/3-114, Закона о раду РК бр.03 / 3-212, Закона о предуниверзитетском образовању РК бр. 04/3 -032, на основу Административног упутства (МОНТ) бр.05/2021 о нормативу професионалног кадра општег образовања, на основу Административног упутства (МОНТ) бр.05/2015 о нормативу за наставнике професионалног образовања и на основу Административног упутства 07/2017 о регулисању процедура конкурса у јавним сектору Одељење за образовање и културу, објављује:

**КОНКУРС**

за допуну слободних радних места

| Позиција | Наставни часови | Коефиц ијент | Период уговора | Назив надзорног | Број позиција |
|---|---|---|---|---|---|
| Наставник разредне наставе | 20 | E19-5.6 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 3 |
| Наставник физичког васпитања | 20 | E19-5.6 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 3 |
| Наставник биологије | 20 | E19-5.6 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 2 |
| Наставник хемије | 20 | E19-5.6 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 1 |
| Наставник историје | 20 | E19-5.6 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 1 |
| Наставник ликовне културе | 20 | E19-5.6 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 2 |
| Наставник информатике | 20 | E19-5.6 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 1 |
| Наставник техничког образовања | 20 | E19-5.6 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 1 |
| Укупно | | | | | 14 |

| Позиција | Наставни часови | Коефиц ијент | Период уговора | Назив надзорног | Број позиција |
|---|---|---|---|---|---|
| Професор економских предмета | 20 | E17-5.8 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 2 |
| Професор машинских предмета | 20 | E17-5.8 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 1 |
| Професор грађевинских предмета | 20 | E17-5.8 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 1 |
| Професор информатичких предмета | 20 | E17-5.8 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 2 |
| Професор правних предмета | 20 | E17-5.8 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 3 |
| Професор биологије | 20 | E17-5.8 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 1 |
| Професор психологије | 20 | E17-5.8 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 1 |
| Укупно | | | | | 11 |

| Позиција | Радни сати | Коефици јент | Период уговора | Назив надзорног | Број позиција |
|---|---|---|---|---|---|
| Администратор | 40 | GJ47-3.88 | На неодређено време (уз предходно потврђени пробни рад) | Директор Одељења за образовање | 3 |
| Укупно | | | | | 3 |

**Главни задаци : Наставно особље**

- Да реализује наставни план и програм за дотично радно место, на основу закона и подзаконским актима које регулишу релевантне области за наведено радно место;
- Да припреми редовни годишњи, месечни и дневни план, у складу са потребама за усклађивање наставе, способности и индивидуалних талената сваког ученика;
- Да има знања о ширем репертоару наставних стилова и да буде у стању да их примењује тако да најбоље одговарају ситуацији у учионици;
- Да планира, руководи и надгледа наставу и понашање сваког ученика;
- Да спроводи нове методологије наставе и процене у складу са упутствима;
- Да учествује у организационом раду школе;
- Да активно учествује у припремању програма и догађаја у школи;
- Да покаже поштовање, колегијалност и не-дискриминационо понашање према сарадницима са којима ради;
- Да поштује директан ауторитет службеника, и да обавља обавезе које му могу одредити. Радни задаци треба да буду у складу са важећим законодавством.
- Да одржи час разредног и дневног дежурства;
- Запослени је у обавези да поштује кодекс облачења и понашања, који је одређен интерном уредбом школе и другим законским и подзаконским актима;

**Услови и квалификације: Наставно особље**

-Едукативни факултет (Мастер 300 ECTS),
-Четворогодишњи систем,
- Bachelor – (четворогодишњи 240 ECTS)

**Главни задаци: Администратор**

-обавља стручне послове из области економије или права,

-послове у вези са заснивањем и престанком радног односа,

-распоређивање и друге промене статуса радника,

-формирају и ажурирају базу и досијее запослених у установи,

- издају потврде уценицима за разне сврхе ,

-воде евиденцију о упису и испису из установе, преузимају и заводе пошту у деловодник, уручују адресатима, одашиљу пошту, истичу опште и појединацне акте на огласну таблу, записнике органа, обавештења,

-обављају остале административне послове за потребе запослених и ученика,

-обављају друге послове у складу са потребама и наредбама

**Услови и квалификације: Администратор**
-Висока стручна спрема- минимум три године
-Област- економија или право

**Кандидати приликом апплицирања подносе следећу документацију:**
- Формулар за пријаву (апликација);
- Факултетска диплома - (оверена копија);
- Лична карта (копија)
- Уверење да није под истрогом
- Доказ о радном искуству ( уколико га поседује)

**Конкурс (рок аплицирања) је отворен 15 дана од 25.05.2023- 08.06.2023. године**

Формулари за пријаву се могу преузети и поднети сваког радног дана у писарници општине Грачаници у периоду од 08:00 до 16:00 часова.
На разговор ће бити позвани само кандидати који испуњавају критеријуме и уђу у ужи избор.
Пријаве мушкараца и жена из свих заједница су добродошле.
Пријаве предате након истека рока неће бити прихваћене, а неисправне пријаве ће бити одбијене.

Директор
Б[illegible]кица Нићић

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Artan Gurgushka shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VlIl shfmu " Motrat Qiriazi " Prizren.

- Nexhat Xhemaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - lX shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

- Gentiana Gashi shpall te pavlefshme dëftesat , certifikatën , diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Andi Haxhiu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Sadri Berisha nga Lipoveci KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. Shaban Gola” nga kl. I-V dhe VI-IX Lipovec.

- Alban Miftari nga Gjkova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Vildane Braha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Tekstil.

- Astrit Duraku shpall të pavlefshme dëftesat, diplomën si dhe certifikatën e maturës të shkollës “Hoxhë Kadri Prishtina” Prishtinë.

- N.T.SH ''FIBELLO'' Shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 810558330.

- N.T.SH ''FIBELLO'' shpall te pavlefshme certifikatën e TVSH-SE me numër 330217564.

- N.T.SH''FIBELLO'' shpall te pavlefshme certifikatën e numrit fiskal me numër ''600694732.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA

ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA

**DREJTORIA PËR ARSIM DHE KULTURË**

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë nr.06/L-114, Ligjit të Punës në RK-së nr.03/L-212, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në RK-së nr.04/L-032 dhe në bazë të Udhëzimit administrativ (MASHT) nr.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit administrativ (MASHT) nr.05/2015 për normativin për mësimdhënësit e arsimit profesional dhe në bazë të Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Drejtoria për Arsim dhe Kulturë shpall këtë:

## KONKURS

për plotësimin e vendeve të lira të punës

| Pozita | Orë mësimore në javë | Koefici enti | Periudha e kontratës | Emri i eprorit | Numri i pozitave |
|---|---|---|---|---|---|
| Mësimdhënës i mësimit klasor | 20 | E19-5.6 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 3 |
| Mësimdhënës i edukatës fizike | 20 | E19-5.6 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 3 |
| Mësimdhënës i biologjisë | 20 | E19-5.6 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 2 |
| Mësimdhënës i kimisë | 20 | E19-5.6 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 1 |
| Mësimdhënës i historisë | 20 | E19-5.6 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 1 |
| Mësimdhënës i kulturës së artit | 20 | E19-5.6 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 2 |
| Mësimdhënës i informatikës | 20 | E19-5.6 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 1 |
| Mësimdhënës i arsimit teknik | 20 | E19-5.6 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 1 |
| Në total | | | | | 14 |

| Pozita | Orë mësimore në javë | Koeficie nti | Periudha e kontratës | Emri i eprorit | Numri i pozitave |
|---|---|---|---|---|---|
| Profesor i lëndëve ekonomike | 20 | E17-5.8 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 2 |
| Profesor i lëndëve mekanike | 20 | E17-5.8 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 1 |
| Profesor i lëndëve ndërtimore | 20 | E17-5.8 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 1 |
| Profesor i lëndëve informatike | 20 | E17-5.8 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 2 |
| Profesor i lëndëve juridike | 20 | E17-5.8 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 3 |
| Profesor i biologjisë | 20 | E17-5.8 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 1 |
| Profesor i psikologjisë | 20 | E17-5.8 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 1 |
| Në total | | | | | 11 |

| Pozita | Orë pune | Koeficie nti | Periudha e kontratës | Emri i eprorit | Numri i pozitave |
|---|---|---|---|---|---|
| Administrator | 40 | GJ47-3.88 | Për një periudhë të pacaktuar (me punë provuese të konfirmuar më parë) | Drejtor i Drejtorisë së Arsimit | 3 |
| Në total | | | | | 3 |

**Detyrat kryesore: Stafi mësimor**

- Të realizojë plan-programin mësimor për vendin përkatës të punës, duke u bazuar në ligjin dhe aktet nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin përkatës të punës;
- Të përgatisë me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor, në përputhje me korrikulën, e në pajtim me kërkesat për përshtatjen e mësimdhënies, aftësive dhe prirjeve individuale të çdo nxënësi;
- Të ketë njohuri për një repertor të gjerë të stileve të mësimdhënies dhe të jetë në gjendje t'i aplikojë ato që më së miri i përgjigjet situatës në klasë;
- Të planifikojë, të udhëheqë dhe të vëzhgojë nxënien dhe sjelljen e çdo nxënësi;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;
- Të marrë pjesë në punën organizative të shkollës;
- Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe ngjarjeve në shkollë;
- Të tregojë respekt, sjellje kolegjiale dhe jodiskriminuese ndaj bashkëpunëtorëve me të cilët punon;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'i përcaktohen. Detyrat e punës duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Të mbajë orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore;
- I punësuari është i obliguar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuara me rregulloren e brendshme të shkollës dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore.

**Kushtet dhe kualifikimi: Staf mësimor**

- Fakulteti i Edukimit (Master 300 ECTS),
- Sistemi katërvjeçar,
- Bachelor – (katërvjeçar 240 ECTS).

**Detyrat kryesore: Administrator**

- Kryen punë profesionale në fushën e ekonomisë ose juridikut;
- Detyrat që kanë të bëjnë me krijimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës;
- Sistemimi dhe ndryshimet e tjera në statusin e punëtorëve;
- Krijon dhe përditëson bazën e të dhënave dhe dosjet e punonjësve në institucion;
- Lëshon vërtetime për nxënësit për qëllime të ndryshme;
- Mban evidencë për regjistrimin dhe çregjistrimin nga institucioni, pranon dhe regjistron postën në librin përkatës, e dorëzon atë tek adresuesit, e dërgon postën, i vendos aktet e përgjithshme dhe individuale në tabelën e shpalljeve, procesverbalet e autoriteteve, njoftimet;
- Kryen detyra të tjera administrative për nevojat e punonjësve dhe nxënësve;
- Kryen detyra të tjera në përputhje me nevojat dhe urdhrat.

**Kushtet dhe kualifikimi: Administrator**

- Arsimi i lartë profesional - minimumi tre vjet
- Fusha – ekonomisë ose juridikut

**Gjatë aplikimit, kandidatët paraqesin dokumentet e mëposhtme:**

- Formulari i aplikimit (aplikacion);
- Diploma e fakultetit - (kopje e vërtetuar);
- Letërnjoftimi (kopje);
- Vërtetimi se nuk është nën hetime;
- Dëshminë për përvojën e punës (nëse e posedon)

**Konkursi (afati i aplikimit) është i hapur 15 ditë nga 25.05.2023 - 08.06.2023.** Formularët e aplikimit mund të shkarkohen dhe dorëzohen çdo ditë pune në Shkrimoren e Komunës së Graçanit nga ora 8:00 deri në orën 16:00.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe kanë hyrë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë.
Aplikacionet nga burrat dhe gratë nga të gjitha komunitetet janë të mirëseardhura.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk do të pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta do të refuzohen.

Drejtoresha
Brankica Ničić




RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100% mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues